


REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Republika e Kosovës;
Kuvendi i Komunës së Junikut;
Numër: 02-180/01/23
Datë: 20.01.2023 .

Në bazë të nenit 43 paragrafi 3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 30 paragrafi 6 të Statutit të Komunës së Junikut (vendimi i Kuvendit të Komunës së Junikut numër 001/26 i datës 29.9.2010) dhe neni 8 të Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Junikut iu bënë këtë:

FTESË

Për: Anëtarët e Kuvendit të Komunës së Junikut;
Nga: Shpejtim Gacaferi – kryesues i Kuvendit të Komunës së Junikut;
Lënda: Mbledhja e parë - (2023) e rregullt e Kuvendit të Komunës së Junikut;
Vendi: Salla e Kuvendit të Komunës së Junikut;
Data: 27.01.2023, ora 10⁰⁰.

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të Punës i Kuvendit Komunal për vitin 2022;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të Punës të Keshillit Komunal për Siguri në Bashkësi / KKSB /;
4. Raporti Financiar vjetor janar-dhjetor 2022;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i projekt-Rregullores Edukativo – Arsimore (leximi i parë);
6. Marja e vendimit për formimin e Komitetit për Shërbime Publike;
7. Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt-Rregullores për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale për vitin 2023 (leximi i dytë);
8. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për nxerrjen e vendimit për nisjen e Procedurave për Themelimin e Ndërmarrjes Publike Lokale (NPL);
9. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për fillimin e procedurave për hartimin e Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Junikut;
10. Marja e Vendimit për formimin e komisionit për zgjedhjen e këshillave lokale në Komunën e Junikut;
11. Marja e Vendimit për formimin e komisionit të ankesave lidhur me procesin e zgjedhjeve të këshillave lokale;
12. Të ndryshme;

REPUBLICA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
 REPUBLIC OF KOSOVA
 KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK
 01/Nr. Prg. 2-155/657
 Mje. Grg. 1
 Nr. i Fax. 18/01 1203
 Data 18/01 2023



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
 KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK - MUNICIPALITY OF JUNIK

DATE/A:	18.01.2023
PËR/ZA/TO:	z. Shpejtim Gacaferi – Kryesues i Kuvendit Komunal
NGA/OD/FROM:	z. Demokrat Ganiqaj – Drejtor për Shërbime Publike Inspeksion, Mbrojtje dhe Shpëtim
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë



I nderuar,

Duke u bazuar ne Ligjet e Republikës se Kosovës, - Ligjit nr.04/L-111 Për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 për ndërmarrjet publike, dhe Rregulloren nr.02/2013 mbi kriteret për krijimin e ndërmarrjeve publike lokale dhe pjesëmarrja e komunave në bordet e drejtorëve të ndërmarrjeve rajonal të ujit, dhe Rregullores (QRK) Nr.02/2013 mbi kriteret e ndërmarrjeve publike lokale dhe pjesëmarrja e komunave në bordet e drejtorëve të ndërmarrjeve rajonale të ujit.

Kërkoj që të rutet si pikë e rendit të ditës në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe në mbledhjen e radhës të Kuvendit Komunal, fillimi i procedurave për themelimin e Ndërmarrjes Publike Lokale.

Me respekt!



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA	
REPUBLIC OF KOSOVA	
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK	
01/Nr. Prot.	2-155/658
Një. Org	7
Nr. i faq.	7
Data	18/01/2023



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK - MUNICIPALITY OF JUNIK

DATE/A:	18.01.2023
PËR/ZA/TO:	z. Shpejtim Gacaferi – Kryesues i Kuvendit Komunal
NGA/OD/FROM:	z. Demokrat Ganiqaj – Drejtor për Shërbime Publike, Inspeksion, Mbrojtje dhe Shpëtim
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë



I nderuar,

Bazuar në kompetencat e Drejtorisë për Shërbime Publike, Inspeksion, Mbrojtje dhe Shpëtim, kërkoj që të futet si pikë e rendit të ditës në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe në mbledhjen e radhës të Kuvendit Komunal, **fillimi i procedurave për hartimin e Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Junikut.**

Me respekt!



REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK / OPŠTINA JUNIK / MUNICIPALITY OF JUNIK
01/Nr. Prot. 2-155/706
Nr. 01 7
Nr. U. Eq. 7
Data 20/01/2023



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY JUNIK


DATË/A:	19.01.2023
PËRMES/PREKO/THROUGH:	z. Ruzhdi Shehu - Kryetar i Komunës, Junik
PËR/ZA/TO:	z. Shpejtim Gacaferi - Kryesues i Kuvendit Komunal, Junik
NGA/OD/FROM:	Leonora Shehu - Drejtoreshë për Administratë të Përgjithshme
TEMA/SUBJEKTA/SUBJECT:	Kërkesë



I nderuar,

Drejtoria për Administratë të Përgjithshme, bazuar në nenin 62, paragrafi 62.3 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës së Junikut Nr. 001/3127, të datës 29.09.2010, dhe Udhëzimit Administrativ 02/2019 për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e Komunave me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane, kërkojmë që të vendosni në rendin e ditës kërkesën për shqyrtimin dhe miratimin e anëtarëve të komisionit për zgjedhjen e këshillave lokale në Komunën e Junikut dhe anëtarëve të komisionit të ankesave lidhur me procesin e zgjedhjeve të këshillave lokale.

Me respekt!



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK– MUNICIPALITY JUNIK

DATE/A:	16.01.2023
PËR/ZA/TO:	z.Shpejtim Gacaferi - Kryesues i Kuvendit Komunal në Komunën e Junikut
PËRMES/PREKTO/ THROUGH:	z.Ruzhdi Shehu - Kryetar i Komunës së Junikut
NGA/ OD/FROM/	z.Besart Tofaj - Nënkyetar i Komunës së Junikut – Koordinator i Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi
TEMA/ SUBJEKTA/ SUBJECT	Kërkesë për të shtuar në rend dite në mbledhjen e radhës së Kuvendit Komunal – Informata e dytë – 2022 dhe raporti vjetor i KKSB-së për vitin 2022.

I nderuar,

Bazuar në nenin 9, pika 1.8 e Udhëzimit Administrativ Nr. 27/2012 MPB – 03-2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi,
Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi në Komunën e Junikut ju sjell informatën e dytë - 2022, për Kuvendin Komunal në Junik.

Krahas kësaj, ju sjellim edhe raportin vjetor për vitin 2022, të Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi.

Me respekt !



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY JUNIK

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi
16 Janar 2023

Informata e dytë – 2022

i/e nderuar,

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi në Komunën e Junikut, gjatë vitit 2022 ka mbajtur gjithsej gjashtë mbledhje të rregullta, ashtu si parashihet me Udhëzimin Administrativ Nr.27/2012 MPB–03/2012 MAPL, për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi.

Në mbledhjen e katër të rregullt të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, të mbajtur më datë 29 Korrik 2022, është diskutuar mbi gjendjen e sigurisë në Komunën e Junikut, ku nga Komandanti i stacionit së Policisë në Junik z.Rasim Sylja u tha se gjendja e sigurisë kryesisht është e qetë dhe nuk ka qenë ndonjë rast që do ta prishte imazhin e Policisë dhe të sigurisë në Komunën e Junikut, gjithashtu theksoj se sfida në vete pararqet mungesa e hapësirave për parking të veturave, por që lëvizja e lirë ekziston dhe është në tolerancën e lejuar.

Në këtë mbledhje u raportua për gjendjen me pandeminë COVID-19, ku nga drejtori për Shëndetësi u tha se situata me pandeminë qëndron mirë dhe në këtë ka ndikuar edhe rekrutimi i katër Mjekëve, gjithashtu u tha se tashmë është rregulluar edhe furnizimi me barna.

Pika tjetër për diskutim ishte mbrojtja e lumenjeve, deponite ilegale dhe menaxhimin e mbeturinave, ku nga drejtori për Shërbime Publike u tha se gjendja me mbrojtjen e lumenjëve është e mirë, dhe se nuk kemi pasur raste ku operatorët ekonomik marrin zhavor në shtratin e Lumit Erenik. Sa i përket deponive ilegale u tha se si drejtori kanë bërë identifikimin e deponive ilegale të vogla, gjithashtu rreth menaxhimit të mbeturinave u theksua se për rreth një vit nuk ka kompani të kontraktuar për grumbullimin e mbeturinave por që Komuna do të bëjë një zgjidhje sa i përket kësaj çështje.

Pikë tjetër që u diskutua ishte edhe për prerjen ilegale të pyjeve, gjuetinë dhe peshkimin e paligjshëm, ku nga anëtarët u bë thirrje që të ju lejohet furnizimi me dru të thata, ndërsa rreth gjuetisë dhe peshkimit të paligjshëm nga drejtoresha për Ekonomi dhe zhvillim, u tha se nuk ka pasur asnjë rast të tillë që ka bërë kërkesë në Komunë apo që është raportuar, ndërsa për qështjen me furnizim me dru tha se kërkesat e qytetarëve janë sygjeruar për adresim në Agjensionin e Parkut sepse ato pyje nuk menaxhohen nga ne. Pikë tjetër që u diskutua ishte edhe zjarret fushore dhe malore, ku foli Komandanti i zjarrfikësve z.Shkelzen Shehu, i cili tha se kemi pasur disa zjarre fushore dhe malore por që kemi arritur ti lokalizojmë shpejtë dhe me sukses dhe bëri thirrje që të merren masa ndëshkuese ndaj atyre individëve që shkaktojnë zjarr-vënie të qëllimshme.

Në pikën e të ndryshme u adresuan disa kërkesa, por dhe ide që zhvillohet një fushatë për siguri në bashkëpunim në mes të Komunës së Junikut, Policisë së Kosovës dhe Komitet Lokal për Siguri Publike, ku edhe mori mbështetjen që kjo fushatë të realizohet.

Mbledhjen e katër e ka kryesuar z.Besart Tofaj, Nënkryetar i Komunës Junik.

Në mbledhjen e pestë të rregullt të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, të mbajtur më datë 29 Shtator 2022, është diskutuar për disa qështje me rëndësi, fillimisht u shqyrtua dhe miratua dorëheqja e një anëtari të KKS-së.

Lidhur me sigurinë në Komunën e Junikut, foli Komandanti i stacionit së Policisë në Junik z.Rasim Syla i cili tha se gjendja e sigurisë është e qetë dhe stabile, dhe se stacioni i Policisë në Junik ka projekte të ndryshme që ndërlidhen me rendin publik, rregullimin e komunikacionit, sigurisë së shkollave dhe projekte për parandalimin e prerjeve ilegale të pyjeve. Gjithashtu theksoj se aktuale është edhe tema e dhunës në familje ku u kërkua që të ketë diskutim më të gjërë, ku dhe mori përkrahjen që të mbahet një fushatë vetëdijësuese për këtë qështje, krahas kësaj Komandani tha se sfidë mbetet edhe qështja e trotuareve.

Pikë tjetër ishte edhe fatkeqësive natyrore dhe fatkeqsitë tjera, ku raportoj Komandanti i zjarrfikësve z.Shkelzen Shehu, i cili tha se kanë bërë vlerësimin e rrezikut, dhe në bazë të statistikave përpos vërshimeve në pranverë, zjarreve fushore dhe malore, aksidentet në komunikacion kemi pasur shumë pak. Gjithashtu tha se fushata vetëdijësuese ka arritur efekte të kënaqëshme. Ndërsa, Kryetari i Komunës së Junikut z.Ruzhdi Shehu tha që kemi krijuar Shtabin Emergjent lidhur me vërshimet dhe se jemi në monitorim të ngritjes së nivelit të ujit në Lumin Erenik dhe Trava.

Në pikën e të ndryshme u adresuan disa pyetje rreth furnizimit me dru për djegje në shkolla, ku u tha se furnizimi do të bëhet së shpejti. Gjithashtu u diskutua qështja e qenëve endacak ku u theksua se jemi në pritje të strategjisë që është duke u përgaditur nga niveli qendror.

Mbledhjen e pestë e ka kryesuar z.Ruzhdi Shehu, Kryetar i Komunës Junik.

Në mbledhjen e gjashtë të rregullt të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, të mbajtur më datë 6 Dhjetor 2022, është diskutuar për shumë qështje, duke filluar me prezantimin e anëtarit të ri të emëruar të KKS-së. Ndërsa në pikën rreth gjendjes së sigurisë në Komunën e Junikut, fjalën e mori Komandanti i stacionit së Policisë në Junik z.Rasim Syla i cili tha se siguria në Komunën e Junikut është në nivel shumë të kënaqshëm dhe se për këtë meritohet janë qytetarët e Komunës së Junikut.

Pikë tjetër ishte edhe informatë mbi shërbimet shëndetësore dhe imunizimin e qytetarëve, ku nga drejtori për Shëndetësi, informuan lidhur me shërbimet në QKMF, ku u tha se shërbimet janë në nivel shumë të mirë, gjendja është stabile dhe se imunizimi i qytetarëve po vazhdon me rregull.

Në pikën tjetër u shqyrtua plani i punës për vitin 2023, ku antarët kishin vërejtjet e tyre si dhe kërkuan që ndër të tjera të shtohet në këtë plan, diskutimi rreth gjendjes së të moshuarve në Komunën e Junikut.

Pikë tjetër ishte edhe informatë mbi vërshimet në Komunën e Junikut, ku u tha nga Komandani i zjarrfikësve se kemi pasur shumë dëme në shtratin e Lumit Erenik, në prona bujqësore dhe private, dhe se së shpejti do të kemi edhe raportin mbi dëmet që kanë shkaktuar këto vërshime.

Mbledhjen e gjashtë e ka kryesuar z.Besart Tofaj, Nënkryetar i Komunës Junik.



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK– MUNICIPALITY JUNIK

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi
16 Janar 2023

Raport i punës për vitin 2022

i/e nderuar,

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi në Komunën e Junikut, gjatë vitit 2022 ka mbajtur gjithsej gjashtë mbledhje të rregullta, ashtu siç është e paraparë me Udhëzimin Administrativ Nr.27/2012 MPB–03/2012 MAPL, për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi.

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi në Komunën e Junikut në gjashtë takimet që ka mbajtur ka përfshirë të gjitha temat që kanë qenë të planifikuara në planin e punës për vitin 2022, ku vlerësojmë që plani i punës është realizuar me sukses, dhe pjesëmarrja dhe angazhimi në diskutim të shumë qështjeve nga anëtarëve të këtij këshilli ka qenë shumë e mirë.

Gjatë vitin 2022, Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi në Komunën e Junikut ka mbështetur realizimin e fushatave vetëdijësuese, dhe jemi shprehur të gatshëm që të diskutojmë dhe të mbështetim fushata të tilla edhe në të ardhmen por edhe thirrje për sensibilizim të përbashkët e që kanë të bëjnë me sigurinë publike.

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi në Komunën e Junikut në vitin 2022, në bashkëpunim me Kuvendin Komunal ka bërë zëvendësimin e një anëtari të këtij këshilli i cili kishte dhënë dorëheqje.

Gjithashtu, në Kuvendin Komunal është dërguar edhe informata e parë për vitin 2022, ashtu siç parashihet me udhëzimin administrativ përkatës.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK
OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK



REFERENC-Ë:	Numër: 02-13/22
PËR/ZA/TO:	Anëtarët e Kuvendit Komunal Junik
NGA/OD/FROM	Shpejtim Gacaferi - Kryesues i Kuvendit Komunal Junik
DATË/A	29.12.2022
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT	Procesverbal

Në bazë të nenit 49 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 32 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Junikut, dhe nenit 18 paragrafi 1, i Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, KK - Junik mbanë këtë:

PROCESVERBAL:

Me rastin e mbajtjes së mbledhjes së trembëdhjetë (13) të Kuvendit të Komunës së Junikut, me datë: 29.12.2022, duke filluar në ora 10:00. Mbledhjen e hapi dhe e udhëhoqi Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Junikut: z. Shpejtim Gacaferi: i cili në fillim përshëndeti, Kryetarin e komunës së Junikut z.Ruzhdi Shehu, nënkryetarin e Komunës së Junikut z. Besart Tofaj, drejtorët e drejtorive komunale, anëtarët të Kuvendit Komunal, zyrtarët Komunal, dhe gjithë të pranishmit. Në mbledhje nga drejtorët prezent ishin: znj.Leunora Shehu-DA, znj.Vjollca Qestaj-DBF, znj.Gentiana Tofaj-DZHE, z.Zenun Shala-DUKM, z.Xhavit Velijaj DKRS, z.Fatos Shala-DSHMS.

Anëtarët prezent

1. Shpejtim Gacaferi - Kryesues, LDK
2. **Sadri Krasniqi – Anëtar, LDK(Mungoi)**
3. Alfred Gaxherri - Anëtar, LDK
4. Mursel Salihaj-Anëtar,LDK
5. Ermelinda Lllolluni - Anëtare, LDK
6. Lirjeta Shehu - Anëtare, LDK
7. Leonard Lllolluni - Anëtar, AAK
8. Zenel Maloku - Anëtar, AAK
9. Dervish Bajraktari - Anëtar, AAK
10. Rajmonda Krasniqi - Anëtare, AAK
11. Erleta Qestaj - Anëtare, AAK
12. Festina Maloku - Anëtare, AAK
13. **Lulzim Gacaferi- Anëtar, LVV (Mungoi)**
14. Eliza Pepshi-Anëtare,LVV
15. Xhemë Tofaj-Anëtar LVV

Rendi i ditës i paraparë

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i orarit të mbajtjes së mbledhjeve të Kuvendit Komunal në Komunën e Junikut për citin 2023,
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës së Kuvendit për vitin 2023,
4. Shqyrtimin dhe aprovimi i Projekt-Rregullores për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale për vitin 2023 (leximi i parë),
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës së KKSB_së për vitin 2023,
6. Shqyrtimi i Raportit të Përformancës për vitin 2021,
7. Shqyrtimi i Raportit të përmbushjes së Planit të Integritetit,
8. Shqyrtimi dhe miratimi i natarëve të Komisionit për përzgjedhjen e Drejtorit të Shkollës Filllore të Mesme të Ulët "Edmond Hoxha" në Junik,
9. Shqyrtimi dhe aprovimi i raportit të vlerësimi të dëmeve të shkaktuara nga vërshimet e datës 20,21,22.11.2022,
10. Shqyrtimi dhe aprovimi i Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Bashkëpunimin e Komunës në Fshatra, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane në territorin e Komunës së Junikut leximi i dytë, dhe
11. Të ndryshme.

Pasi konstatoi se në mbledhje marrin pjesë 13 anëtarët e kuvendit kryesuesi mungojnë z. Sadri Krasniqi dhe z.Lulzim Gacaferi, me pas e hodhi në votim rendin e ditës të propozuar dhe rendi i ditës u miratua me 13 vota për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,

z.Zenel Maloku, përshëndetje për të gjithë, sa i përket procesverbalit e kam cekur edhe në mbledhjen e kaluar se që të shkruhen fjalët ashtu siç i thotë delegati mos të ndryshoj, ose ai që i ndryshon ndërrone, ka këtu në komune tjerë . Kryesues këtu të fjalja ime që thuhet se tu kam drejtuar me fjalën mos u zgërdhi, e unë të kam thënë mos u kesh se nuk je ka del mirë dhe kjo është një far lloje rrene që nuk duhet me e përdorë, unë kam thënë mos u kesh por jo mos u zgërdhi. Dhe çështja tjetër është për rastin që ka ndodhur në bjeshkë rasti i familjes nga Istogu që ka të bëjë se kam kërkuar një automjet xhip për QKMF-ne, kjo pjesë e fjalisë time nuk është në procesverbal.

z.Shpejtim Gacaferi. Çështje tjetër nuk ka, e qes në votim procesverbalin e mbledhjes se kaluar, prezent në sallë janë 13 anëtarët e kuvendit kush është për? për 13 vota, kundër 0 vota, abstenim 0 vota, konstatoi se procesverbali miratohet me këto vërejtjet që i ceki z. Zenel Maloku.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i orarit të mbajtjes së mbledhjeve të Kuvendit Komunal në Komunën e Junikut për citin 2023,

Shqyrtimin dhe arsyetimin para anëtarëve të kuvendit për këtë pikë e beri z.Shpejtim Gacaferi kryesues i Kuvendit të Komunës së Junikut.

z.Leonard Llojuni, përshëndetje për të gjithë, të mbledhja e paraparë në shtator është paraparë të mbahet me dt. 27.09.2023 dite e mërkurë pse me këtë datë dhe këtë ditë pse nuk ka mbetur në ditën e Premte? se sa i përket mbledhjes së Qershorit është e kuptueshme se i ka ra e premtja e fundit e muajit Qershor, por kjo për shtator nuk po e kuptojë pse?

z.Shpejtim Gacaferi, po në shtator miratohet buxheti dhe për arsye që afati i fundit për ta dërguar të miratuar buxhetin në qeveri është data 30 Shtatori dhe që ekzekutivi të këtë kohë që nëse hasim në ndonjë ndryshim sapo pakënaqësi si që patëm edhe në miratimin e fundit të buxhetit. Atëherë e qes në votim Shqyrtimi dhe miratimi i orarit të mbajtjes së mbledhjeve të Kuvendit Komunal në Komunën e Junikut për vitin 2023, kush është për? për 13 vota, kundër 0 vota dhe abstenim 0 vota konstatoi se kjo pikë e rendit të ditës u miratua.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës së Kuvendit për vitin 2023,

Shqyrtimin dhe arsyetimin e planit të punës së Kuvendit për vitin 2023 para anëtarëve të kuvendit e beri Kryesuesi i Kuvendit z.Shpejtim Gacaferi. Kërkesë nuk pati e qes në votim planin e punës së kuvendit për vitin 2023 kush është për? për 13 vota, kundër 0 vota dhe abstenime 0 vota, konstatoi se plani i punës së Kuvendit për vitin 2023 u miratua.

4. Shqyrtimi dhe aprovimi i Projekt-Rregullores për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale për vitin 2023 (leximi i parë),

Shqyrtimin dhe arsyetimin para anëtarëve të kuvendit e beri z.Vjollca Qestaj e cila fillimisht i përshëndeti të gjithë të pranishmit, dhe me pas e arsyetoi para anëtarëve të kuvendit Projekt-Rregullores për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale për vitin 2023.

z.Leonard Llojuni, sa i përket rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoha të neni 6 pika 6.8 lidhur me taksa komunale për veprimtari në biznes, po me intereson në baze të cilave kriteret keni ardhur deri të taksa që keni caktuar për Fabrikën për përpunimin e Ujit në shumë prej 400€, për deri sa fabrika e përpunimit të ujit, paguan 550€ për qiranë 2000€ tatim në pronë po ashtu kemi paguar edhe leje pëlqim prej Komunës për vendosjen e trafos në shumë prej 3000€, edhe po me intereson të di se si keni ardhur deri të kjo shumë, dhe fabrika e ujit është veprimtari prodhuese e në këtë kategori e keni futur edhe kompaninë për mbledhjen e mbeturinave Ambienti.

znj.Gentiana Tofaj, përshëndetje për të gjithë, arsyeja se pse është në atë kategori të veprimtarisë sepse është biznes si gjitha bizneset tjera dhe për këtë arsyeje nuk kemi bërë ndryshime i kemi përfshirë të gjitha bizneset në të njëjtën veprimtari, ndërsa sa i përket çmimit të caktuar në e kemi parë të arsyeshme që shuma të jetë ajo që është cekur.

z.Ruzhdi Shehu, përshëndetje për të gjithë, edhe unë mendoj që të grupëzimi i veprimtarive banesore duhet të bëhet , duhet të ndahen biznese që janë biznese me veprimtari prodhuese

bizneset shërbyese, bizneset me veprimtari ndërtimore, mendoje se grupi punues duhet ta marrin edhe një here këtë rregullore dhe kjo të përmirësohet.

z.Leonard Lolluni, kryesues unë nuk votoi për këtë pike për arsyeje se mund të quhet konflikt interesi.

z.Shpejtim Gacaferi, kërkesë tjetër nuk ka e qes ne votim Projekt-Rregulloren për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale për vitin 2023 (leximi i parë), kush është për? për 10 vota, kundër 0 vota dhe abstenim 2 vota konstatoi se Projekt-Rregullores për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale për vitin 2023 (leximi i parë), u miratua.

5. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës së KKSBS për vitin 2023,

Shqyrtimin dhe arsyetimin e beri nënkryetari i Komunës z.Besart Tofaj i cili fillimisht i përshëndeti të gjithë me atë e arsyetoi para anëtarëve të kuvendit Planit të punës së KKSBS për vitin 2023.

z.Shpejtim Gacaferi, kërkesë nuk ka, e qes ne votim kush është për? për 13 vota, kundër 0 vota dhe abstenim 0 vota konstatoi se Planit të punës së KKSBS për vitin 2023 u miratua.

6. Shqyrtimi i Raportit të Përformancës për vitin 2021,

Shqyrtimin dhe arsyetimin e beri koordinatori për performancë z.Rrustem Pepshi i cili fillimisht i përshëndeti të gjithë të pranishmit me pas e sqaroi dhe e arsyetoi Raportin të Përformancës për vitin 2021 para anëtarëve të Kuvendit.

Nuk pati kërkesa apo pyetje.

7. Shqyrtimi i Raportit të përmbushjes së Planit të Integritetit,

z.Zenel Maloku, unë e falënderoj z.Pepshin për këtë raport, dhe gjatë raportimit tha që me e ulë korrupsionin, dhe unë e di se korrupsionin duhet ta heqim krejt, me e ulë i bje 20% atëherë ku po mbeten edhe 80% kështu që unë po them që korrupsionin ta heqim krejt mos me ekzistuar fare.

z.Leonard Lolluni, në faqen numër 5, të menaxhimit të burimeve njerëzore të rekrutimit të stafit, unë nuk po i shohë disa reduktime që kanë ndodhur dhe këtë raport e kanë bërë zyrtarët Komunal andaj do ishte mirë që të janë të cekur edhe këto reduktime në këtë raport, bile ata që janë me ankesa nuk po i shohë fare.

z.Rrustem Pepshi, po janë, e ke në faqen e tretë nga fundi, shkelje të integritetit është nëse ajo ankesë ka bazë ligjore e në këtë rast ankesa nuk ka pasur bazë ligjore.

8. Shqyrtimi dhe miratimi i anëtarëve të Komisionit për përzgjedhjen e Drejtorit të Shkollës Filllore të Mesme të Ulët "Edmond Hoxha" në Junik,

Shqyrtimin dhe arsyetimin e beri z.Xhavit Velijaj, Drejtor për Arsim, i cili fillimisht i përshëndeti te gjithë me pas e sqaroi dhe e arsyetoj para anëtarëve të Kuvendit këtë komision për përzgjedhjen e Drejtorit të Shkollës filllore të mesme të ulët Edmond Hoxha në Junik. Te propozuar për këtë komision janë: z.Arton Krasniqi- zyrtar i lartë për Arsim
z.Beqë Knushi- ekspert për Arsim

z.Dervish Bajraktari, përshëndetje për te gjithë, i kemi dy propozime dhe ne si Kuvend a duhet te kemi propozime te reja apo vete këta te dy do te votohen.

z.Shpejtim Gacaferi, e kemi kërkesë prej drejtorisë së arsimit për këto dy propozime.

z.Dervish Bajraktari, ne mbledhjen e fundit të KPF-se kemi propozuar që komisioni të përbehet prej pesë anëtarëve.

z.Xhavit Velijaj, jemi në fazën e formimit të komisionit për përzgjedhjen e drejtorit të shkollës filllore të mesme e ultë "Edmond Hoxha", dhe në bazë të udhëzimit administrativ 151/ 2020 parashihet që ky komisioni nga drejtoria propozohen dy anëtar mirëpo përbërja e komisionit është prej tre anëtarëve dy nga drejtoria, dhe njëri nga ta duhet të jetë nga drejtoria përkatëse dhe tjetri nga fusha e Arsimit, dhe anëtari i tretë i komisionit vjen nga Ministria e arsimit, si dhe dy janë vëzhgues, një nga këshilli drejtues i shkollës, dhe një nga këshilli i prindërve, këta dy anëtarët që propozohen nga drejtoria duhet të miratohen në Kuvend andaj ne kemi bere këtë kërkesë kuvendit.

z.Leonard Lolluni, ekspertin e arsimit mbi bazën e cilave kritere e keni zgjedhur, në bazë cilit ligj apo cilit kriter?

z.Xhavit Velijaj, në si drejtori kemi menduar se ky propozim i plotëson këto kritere andaj e kemi propozuar sepse vjen nga fusha e arsimit ka përvojën e punës mbi 30 vjeçare.

z.Ruzhdi Shehu, vetëm sa për sqarim shtesë, komisioni përbehet prej tre anëtarëve dhe dy vëzhgueseve, dy propozime vijnë nga DKA-ja një nga Ministria e Arsimit dhe vëzhguesit një nga këshilli i shkollës dhe një nga këshilli i prindërve, tash propozimi i këtij eksperti është sepse ai vjen nga fusha e arsimit është pensionist dhe i pavarur jashtë institucioneve.

z.Leonard Lolluni, është anëtar i LDK, në te gjithë e njohim.

z.Shpejtim Gacaferi, çështje tjera nuk ka, e qes në votim, miratimi i anëtarëve të Komisionit për përzgjedhjen e Drejtorit të Shkollës Filllore të Mesme të Ulët "Edmond Hoxha" në Junik propozimet e ardhura nga DKA-ja kush është për? për 7 vota, kundër 3 vota, dhe abstenim 3 vota, konstatoi se Komisioni në përbërje të z.Arton Krasniqi-zyrtar i lartë për Arsim dhe z.Beqë Knushi-ekspert i pavarur për Arsim miratohet nga Kuvendi.

9. Shqyrtimi dhe aprovimi i raportit të vlerësimi të dëmeve të shkaktuara nga vërshimet e datës 20,21,22.11.2022,

Shqyrtimin dhe arsyetimin e beri z. Shkëlzen Shehu, komandat i njësitit të zjarrfikëseve në Komunë e Junikut si dhe kryesues i komisionit të vlerësimit të dëmeve nga vërshimet, i cili fillimisht i përshëndeti të gjithë me pas e sqaroi dhe e arsyetoi raportin e vlerësimit të dëmeve të shkaktuara nga vërshimet e datës 20,21,22.11.2022, para anëtarëve të kuvendit.

z.Leonard Llojluni, unë e përshëndes këtë raport dhe e përkrahi, uroj që qeveria të na e vlerësojë këtu dëmet që janë shkaktuara nga vërshimet.

z.Xhemë Tofaj, unë vetëm desha ta përshëndes kryesuesin e komisionit z.Shehu për punën e bërë.

z.Ruzhdi Shehu, këso raportesh janë bërë edhe më parë por asnjëherë nuk janë sjellë në Kuvend për miratim, andaj ne kemi sjellë këtë raport këtu në kuvend që edhe kuvendi të informohet për dëmet që janë shkaktuar nga vërshimet.

z.Shpejtim Gacaferi, e qes në votim raportin për vlerësimi të dëmeve të shkaktuara nga vërshimet e datës 20,21,22.11.2022., prezent në sallë janë 12 anëtar të kuvendit, kush është për, për 12 vota, kundër 0 vota dhe abstenim 0 vota, konstatoi se raporti i vlerësimit të dëmeve nga vërshimet u miratua.

10. Shqyrtimi dhe aprovimi i Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Bashkëpunimin e Komunës në Fshatra, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane në territorin e Komunës së Junikut leximi i dytë,

Shqyrtimin dhe arsyetimin e beri znj.Leonora Shehu, drejtoreshë e administratës e cila fillimisht i përshëndeti të gjithë me pas e sqaroi dhe e arsyetoi Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Bashkëpunimin e Komunës në Fshatra, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane në territorin e Komunës së Junikut leximi i dytë, para anëtarëve të Kuvendit.

z.Shpejtim Gacaferi, kërkesë tjetër nuk ka e qes në votim, prezent në sallë janë 13 anëtarët e Kuvendit, kush është për? Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Bashkëpunimin e Komunës në Fshatra, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane në territorin e Komunës së Junikut leximi i dytë, për 13 vota, kundër 0 vota, dhe abstenim 0 vota, konstatoi se Rregullorja për Organizimin, Funksionimin dhe Bashkëpunimin e Komunës në Fshatra, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane në territorin e Komunës së Junikut u miratua.

11. Të ndryshme.

z.Leonard Llojluni, po me nevojitet më shumë informata lidhur me punimet që po ndodhin te restoranti Oda e Junikut, a është kanal për ujërat e zeza, kanal për ujërat e pijes apo çka?

z.Ruzhdi Shehu, pyetje me vend, është pjesë e bashkëpunimit me “Hidrodrinin” e Pejës dhe njësitit tonë këtu që ta lidhim me ujësjellësin e ujit të pijes, edhe pjesën e lagjes në rrugën për Hereq, si dhe në këtë pjesë të lidhim me nga një krua dy pjesët e Lagjes”Agim Ramadani” .

z.Zenel Maloku,u fol për furnizimin me ujin e pijes për dy tri shtëpi e unë po dua të di nga kryetari a e din se sa shtëpi ka Lagjja “Agim Ramadani” e që janë pa ujin e pijes, ujin që e ka tani nuk është i pijes por as për pastrimin e teshave nuk është, andaj do ishte e mirë që edhe Lagjja “Agim Ramadani” të kyqet në ujësjellësin e tanishëm të Junikut, e di se e kemi tepruar edhe kërkesa edhe këtu në kuvend po me të vërtetë do ishte mirë që kjo të ndodhë, ndoshta do ishte më mirë që ta qoni ujin në lagjen “Agim Ramadani” se sa të investoni para në asfalt të prishtë për bjeshkë, kryetar ti edhe ke premtuar që do ta sjellësh ujin e pijes në Lagjen “Agim Ramadani”. Çështja tjetër ka të bëjë me ndreqimin publik aty është punuar keq diku i kanë vendosur në dy shtylla e diku asnjë, çka është me e keqja të shtëpia e Heroit të Kombit nuk keni vendosur fare ndriçim, kjo nuk është e mirë, sepse ju bie në sy njerëzve. Çështja tjetër ka të bëjë me shtrimin e asfaltit në rrugën për bjeshkë që po shtrohet nëpër lloq, a keni qenë ta shikoni se si është ka punohet.

z.Ruzhdi Shehu, uji në lagjen “Agim Ramadani” sipas raporteve që unë marr në baza javore është uji i shëndetshëm dhe që pihet raport që vjen nga Instituti i Shëndetësisë Publike, e dyta kemi masa të Qeverisë që të kursejmë energjinë, por edhe kemi problem që poçet elektrike janë djegur sepse kanë qenë të cilësisë së dobët, për këtë arsyeje kemi diku dritë e diku nuk kemi, por me gjithë këtë ajo është rregulluar dhe afër shtëpisë së Heroit të Kombit ka ndriçim publik, ndërsa sa i përket çështjes së asfaltit në rrugën për bjeshkë është nën mbikëqyrjen edhe të ministrisë, edhe edhe pjesa e jonë e mbikëqyrjes dhe ata kanë bërë raporte për ecurinë e këtyre punëve andaj as unë nuk jam kompetent që ta vlerësoj, dhe për punën e kryer ka edhe garancione nga operatori që bënë kryerjen e këtyre punëve.

z.Shpejtim Gacaferi, e shpalli të mbyllur mbledhjen e Dhjetorit 2022

Procesmbajtësi:

z. Esat Hoxha

Kryesuesi i Kuvendit:

z. Shpejtim Gacaferi



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E JUNIKUT

MUNICIPALITY OF JUNIK - OPŠTINA JUNIK

Referencë:	Numër: 02/180/01/23
Për/ Za/ To:	Anëtarët e Kuvendit të Komunës së Junikut
Nga/ Od/ From:	z. Shpejtim gacaferi – kryesues i Kuvendit të Komunës së Junikut
Datë/ Datum/ Date:	10.01.2023
Tema/ Subjekat/ Subject:	R A P O R T P U N E

Vendi: Komuna e Junikut

Hartuesi: Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Junikut

Lloji i punës: Raport pune

“RAPORTI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË JUNIKUT PËR VITIN 2022”

Junik, janar 2023

Kuvendi i Komunës së Junikut në përputhje me obligimet që dalin nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale, Statuti i Komunës së Junikut, Rregullorja e punës së Kuvendit të Komunës së Junikut dhe ligjet e tjera në Republikën e Kosovës, për vitin 2022 harton këtë:

RAPORT P U N E

Kuvendi i Komunës së Junikut është organi më i lartë i themeluar në përputhje me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale (neni 35).

Kjo është legjislatura e gjashtë e këtij organi e dalë nga zgjedhjet lokale 2021.

Kuvendi i Komunës së Junikut numëron gjithsejtë 15 anëtarë prej të cilëve 8 janë meshkuj dhe 7 femra. Në kuvend janë të përfaqësuara tri subjekte politike: LDK me 6 këshilltarë; AAK me 6 këshilltarë dhe LVV me 3 këshilltarë

Përveç Kuvendit si organ ligjvënës në kuadër të tij janë të themeluara edhe trupa ndihmës siç janë komitetet dhe komisionet. Deri më tash janë të themeluara dy komitete (dy të përhershme Komiteti për Politikë dhe Financa dhe Komiteti për Komunitete) , Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi, 2 komisione (themelimi i Panelit Përzgjedhës të Anëtareve të komitetit konsultativ për personat me aftësi të kufizuara , formimi i komisionit për vlersimin e situatës së ish deponisë së materialeve inerte).

Mirëpo për të gjitha çështjet tjera siç janë dërgimi i materialit, arkivimi si dhe evidentimi protokollar i të gjithë materialit të kuvendit është punuar në përputhje me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Udhëzimin Administrativ MAPL) Nr. 02/2015 për Mbajtjen e Mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, Statutin e Komunës së Junikut dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit të Komunës së Junikut duke respektuar aq sa ka qenë e mundur Planin e punës së Kuvendit të Komunës së Junikut për vitin 2022.

TRAJNIMET DHE PUNTORITË

Gjatë vitit 2022 antaret e Kuvendit Komunal kanë pasur shumë takime njoftuese / trajnime/ qe lidhen me punen e Kuvendit të cilat kanë qenë të pergaditura nga Ministritë dhe Organizatat e ndryshme me qëllimin që anëtarët e Kuvendit të jenë sa me te njoftuar për punën në Kuvend.

Po ashtu ka pasur disa takime te organizuara nga Asociacioni i Komunave të Kosoves ku Kuvendi Komunal i Junikut ka qenë i perfaqesuar nga Antaret (2) të Zgjedhur nga ana e Kuvendit dhe nga Kryesuesi i KK Junik.

Gjatë vitit 2022 Kuvendi i Komunës së Junikut ka mbajtur gjithsejtë 12 mbledhje të rregullta dhe dy (2) mbledhje solemne (17 Shkurti Dita e Pavarësisë së Republikës së Kosovës, dhe 13 Qershori dita e Çlirimit të Junikut) derisa mbledhje të jashtëzakonshme është mbajtur një (1) sepse është paraqitur nevoja.

Pothuajse në të gjitha mbledhjet ka mbizotëruar fryma e arsyes dhe janë trajtuar çështje të rëndësishme për komunën e Junikut.

Komitetet e përhershme Komiteti për Politikë dhe Financa gjatë vitit 2022 kanë mbajtur gjithsejtë 11 mbledhje të rregullta sipas planeve të miratuara nga ana e Kuvendit të Komunës së Junikut, Komiteti për Komunitete ka mbajtur gjithsejtë 9 mbledhje të rregullta, kurse Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi ka mbajtur gjithsejtë 6 mbledhje të rregullta.

Puna e komisioneve të ngritura nga ana e Kuvendit të Komunës së Junikut do të pasqyrohet në raportin e punës së secilit komision veç e veç.

RREGULLORET:

Kuvendi i Komunës së Junikut për vitin 2022 ka miratuar gjithsejtë 3 rregullore (plotesim – ndryshime).

1. Rregulloret e miratuara nga ana e Kuvendit të Komunës së Junikut në vitin 2022 janë:
 - 1.1. Rregullorja për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2023 (vendimi i KKJ numër 02/13/22 i datës 29.04.2022);
 - 1.2. Rregullorja (plotesim – ndryshim) për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me Fshatrat dhe lagjet Urbane (vendimi i KKJ 02/21/22 i datës 30.08.2022); dhe
 - 1.3. Rregullorja (plotesim – ndryshim) për taksa, ngarkesa dhe gjoba komunale (vendimi i KKJ numër 02/24/22 i datës 27.09.2022);

BUXHETI:

I. Buxheti i përgjithshëm i Komunës së Junikut për vitin 2022 ka qenë **1,683,345,91 €**, dhe është i shpërndarë në linjat buxhetore si në vijim:

1. Paga dhe mëditje: **1,102,859.49 €**,
2. Mallra dhe shërbime: **216,446.11 €**,
3. Shpenzime komunale: **32,053.35 €**,
4. Subvencione dhe transfere: **58,885.82 €**,
5. Investime kapitale: **273,101.14 €**.

Përveç kësaj gjatë vitit 2022 Kuvendi i Komunës së Junikut ka nxjerrë gjithsejtë 35 akte prej të cilave të gjitha janë vendime. Nuk ka nxjerrë asnjë rekomandim dhe asnjë njoftim për arsye se për të njëjtat nuk është bërë asnjë kërkesë.

Në vijim në mënyrë tabelore po paraqesim aktet e miratuara nga Kuvendi i Komunës së Junikut në vitin 2022.

AKTET E KUVENDIT TË KOMUNËS SË JUNIKUT PËR VITIN 2022

Nr.	Emërtimi	Numri i vendimit	Data e vendimit	Data e miratimit	Vërejtje
01	Vendimi për datën e mbajtjes së mbledhjeve të rregullta të KK Junik për vitin 2016	02/01	05.01.2022		
02	Vendim për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa .	02/02	01.02.2022	28.01.2022	
03	Vendimi për formimin e Komitetit për Komunitete.	02/03	01.02.2022	28.01.2022	
04	Vendim i perseritur për formimin e Komitetit për Komunitete.	02/04	01.03.2022	28.02.2022	
05	Vendim me të cilin për zgjedhen përfaqësuesit nga radhët e antareve Komunal të Junikut për të marrë pjesë në Kuvendin e Asociacionit të Komunave	02/05	01.02.2022	28.01.2022	

	të Kosovës.				
06	Vendimi për formimin e Grupit të punës për hartimin e (projekt) Planit vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës së Junikut për vitin 2022.	02/06	04.03.2022	28.02.2022	
07	Vendimi për formimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi KKSB	02/07	01.03.2022	28.02.2022	
08	Vendimi për ndryshimin e planit të buxhetit për të hyrat vetanake të vitit 2021.	02/08	31.03.2022	30.03.2022	
09	Vendim për bartjen e të hyrave vetanake të pa shpenzuara në vitin 2021 për shpenzim në vitin 2022	02/09	31.03.2022	30.03.2022	
10	Vendim për përbërjen e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.	02/10	31.03.2022	30.03.2022	
11	Vendim për miratimin e planit të punës së Kuvendit të Komunës së Junikut për vitin 2022	02/11	31.03.2022	30.03.2022	
12	Vendim për Bashkëpunim Komunal Ndërkombëtar.	02/12	05.04.2022	30.03.2022	
13	Vendim për nderprerjen e pagesave të ish zyrtarëve të Kuvendit .	02/13	10.05.2022	29.04.2022	
14	Vendim për shfuqizim të Vendimit të Kuvendit për subvencionimin e të prekurve me COVID-19	02/14	10.05.2022	29.04.2022	
15	Vendim për plotësim - ndryshimin e rregullores për tatim mbi Pronën e paluajtshme për vitin 2023	02/15	10.05.2022	29.04.2022	
16	Vendim për miratimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale 2023-2025	02/16	30.06.2022	29.06.2022	
17	Propozim - Vendim për themelimin e Panellit Përzgjedhes të Antareve të Komitetit Konsultativ për	02/17	30.06.2022	29.06.2022	

	persona me aftesi të Kufizuara.				
18	Vendim për Bashkëpunim Komunal Nderkombëtar.	02/18	30.06.2022	29.06.2022	
19	Vendim për miratimin e listave të pronave të paluajtshme të Komunës për dhenjen në shfrytëzim për afatin kohor 99 vite.	02/19	06.07.2022	29.06.2022	
20	Vendim për themelimin e panellit përzgjedhës të antareve të komitetit konsultativ për personat me aftesi të kufizuara.	02/20	01.08.2022	29.07.2022	
21	Vendim për formimin e grupit të punës për plotësim - ndryshimin e Statutit të QKMF - së.	02/21	02.08.2022	29.07.2022	
22	Vendim për shpalljen e parcelave kadastrale interes publik	02/22		30.08.2022	
23	Vendim për shfuqizimin e vendimit të Kuvendit të Komunës së Junikut me numër 02/19/22	02/23		30.08.2022	
24	Vendim për fillimin e procedurave për plotësim - ndryshim të Rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunes me Fshatrat dhe lagjet urbane.	02/24	01.09.2022	30.08.2022	
25	Vendim për formimin e grupit të punës për hartimin e Projekt - Planit të punës së Kuvendit të Komunës së Junikut për vitin 2023	02/25	05.03.2022	27.09.2022	
26	Vendim për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2023	02/26	27.09.2022	27.09.2022	
27	Vendim për fillimin e procedurave për plotësim ndryshim të projekt Rregullores për taksa , tarifa dhe ngarkesa.	02/27	27.09.2022	27.09.2022	
28	Vendim për plotësim ndryshim të Vendimit Nr.	02/28	27.09.2022	27.09.2022	

	02/04 te dates 05.03.2019 per emerimin e Zonave te Qarkullimit Publik.				
29	Vendim për formimin e grupit punues për plotesim - ndryshim te projekt- Rregullores per taksa , ngarkesa, dhe gjoba Komunale.	02/29	04.11.2022	28.10.2022	
30	Vendim për fillimin e procedurave per hartimin e Rregullores Edukativo - Arsimore.	02/30	04.11.2022	28.10.2022	
31	Vendim për plotesimin e Anëtyareve të KKSB – së.	02/31	04.11.2022	28.10.2022	
32	Vendim për formimin e komisionit për vleresimin e situates se ish deponisë së materialeve inerte.	02/32	22.11.2022	28.10.2022	
33	Vendim për caktimin e orarit të mbledhjeve dhe takimeve të Kuvendit Komunal në Junik.	02/33	29.12.2022	29.12.2022	
34	Vendim për vleresimin e dëmeve te shkaktuara nga reshjet e shiut në Komunën e Junikut te dates 20,21,22.11.2022	02/34	29.12.2022	29.12.2022	
35	Vendim për hapjen e diskutimit publik per miratimin e plotesim ndryshimin e Rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba komunale për vitin 2023	02/35	29.10.2022	29.12.2022	

Përfundim:

Në këtë raport pune janë pasqyruar një numër i konsiderueshëm i aktiviteteve të Kuvendit të Komunës së Junikut, por kurrësi nuk mund ta konsiderojmë si të plotë, pasi që nuk kanë mundur

të pasqyrohen edhe aktivitetet e trupave ndihmës të Kuvendit të Komunës së Junikut për shkak të mungesës së raporteve të punës së tyre vitin 2022 të cilat pas hartimit duhet t'i prezantohen Kuvendit të Komunës së Junikut për shqyrtim dhe miratim.

Përfundimisht Kuvendi i Komunës së Junikut në vitin 2022 ka funksionuar në përputhje me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 02/2015 për Mbajtjen e Mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, Statutin e Komunës së Junikut dhe Rregulloren e punës së Kuvendit të Komunës së Junikut duke u ballafaquar me probleme si të natyrës teknike (logjistike) ashtu edhe të natyrës ligjore dhe bashkëpunimit me ekzekutivin sa u përket respektimit të procedurave ligjore lidhur me shqyrtimin dhe miratimin e dokumenteve strategjike komunale.

Me këtë rast në emër të Kuvendit të Komunës së Junikut Ju falënderoj të gjithë anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Junikut për kontributin e dhënë deri më tash.

Kuvendi i Komunës së Junikut

Shpejtim Gacaferi _____
kryesues



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF
KOSOVO



KOMUNA E JUNIKUT
OPSTINA JUNIK/ MUNICIPALITY OF JUNIK

KOMUNA E JUNIKUT

**RAPORTI I BUXHETIT
KOMUNAL PËR
PERIUDHËN JANAR -
DHJETOR/ 2022**

Junik, Janar -2023

Informata -IV- Financiare Periodike 2022

Kërkesat për raportim

Informata Financiare Komunale për periudhën Janar – Dhjetor 2022, bëhet në bazë të kërkesave për raportim të përkohshëm dhe vjetor bazuar në dispozitat e neneve 46.1 dhe 46.2 të Ligjit Nr. 03/L-048 “Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë” dhe statutit Komunal.

Informata Financiare Komunale Periodike ka për qëllim të informimit objektiv lidhur me ecurinë dhe me treguesit relevant rreth përmbushjes së planit të grumbullimit të mjeteve sipas burimeve, përmbushjes së obligimeve të planifikuara sipas plan programeve, dinamikën e mjeteve të shpenzuara dhe atë sipas natyrës së shpenzimeve dhe kategorive të përcaktuara buxhetore, rrjedhën e parasë si dhe treguesit tjerë që kanë ndikuar në rezultatet e përgjithshme për këtë periudhë.

Ecuria e përgjithshme e këtyre treguesve do të prezantohet për 14 programet buxhetore :

1. Zyra e Kryetarit
2. Kuvendi Komunal
3. Administrata e Përgjithshme
4. Buxhet dhe Financa
5. Zhvillim Ekonomik
6. Shërbimet publike dhe Inspeksion
7. Urbanizëm, Gjeodezi, Kadastër dhe Mjedis
8. ZKK (Zyra Komunale për Komunitete)
9. Shëndetësi
10. Mirëqenie Sociale
11. Shërbimet e kujdesit primar
12. Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport
13. Arsimi i mesëm
14. Arsimi fillor

TË HYRAT DHE SHPENZIMET BUXHETORE PERIODIKE

Ky raport financiar është përgatitur në përputhje me SNKSP (Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik) të bazuar në para të gatshme “Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të bazuar në para të gatshme”. Shënimet në pasqyrat financiare paraqesin pjesë integrale për ta kuptuar pasqyrën, andaj duhet të lexohen së bashku me pasqyrat.

Pasqyrat financiare janë për Komunën e Junikut. Komuna e Junikut kontrollohet nga Qeveria e Kosovës dhe të gjitha aktivitetet e saja financohen nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës.

Komuna e Junikut nuk operon me llogarinë e vet bankare. Qeveria operon me funksion të centralizuar të Thesarit i cili e administron pranimin e parave të gatshme të mbledhura nga të gjitha entitetet buxhetore gjatë vitit financiar. Pagesat e bëra në këtë llogari sa i përket Komunës së Junikut janë të paraqitura në kolonën e llogarisë së vetme të Thesarit në Pasqyrën e Pranimeve dhe pagesave të Parave të Gatshme.

Buxheti i aprovuar në Asamblenë Komunale për vitin 2022 është në vlerë **1,658,591.00€** i cili ka pësuar ndryshime gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2022 për të hyrat nga donacionet dhe donacionet e bartura nga viti 2021 në vlerë **2,469.85€**, Bartja e te hyrave të pashpenzuara të vitit 2021 të bartura për shpenzim në vitin 2022 në shumë prej **91,915.99€**, nga niveli Qendror është rritur kategoria e pagave në shume prej **23,442.28€** për mbulimin e shtesave për përfituesit nga Ligji për rimëkëmbje

ekonomike për punëtorët shëndetësor ne QKMF. Me vendim nga kuvendi komunal është bërë rritja e planit të hyrave vetanake për vitin 2022 në shumë prej **141,719.19** €. Buxheti përfundimtar i përgjithshëm duke përfshirë edhe donacionet është në vlerë **1,918,138.31€**.

Raport i ekzekutimit të Buxhetit

		Buxheti fillestar	Buxheti Aktual	Pranimet - Alokimet	Pagesat (Shpenzimi)	Progresi me plan	% me alokim
Përshkrimi	Ligji Nr. 07-L-041		SIMFK	SIMFK		në, %	në, %
a		b	c	d	e	f =e/c	g =e/d
Gjithsej Pagesat		1+2+3+4+5	1+2+3+4+5	1+2+3+4	1+2+3+4+5		
Totali		1,658,591.00	1,918,138.31	1,846,967.64	1,683,345.91	87.76%	91.14%
Paga dhe Meditje		1,154,611.00	1,178,053.28	1,106,882.61	1,102,859.49	93.62%	99.64%
Mallrat dhe Shërbimet		202,780.00	261,516.69	261,516.69	216,446.11	82.77%	82.77%
Shpenzimet Komunale		36,200.00	36,200.00	36,200.00	32,053.35	88.55%	88.55%
Subvencione dhe Transferet		50,000.00	58,950.00	58,950.00	58,885.82	99.89%	99.89%
Investimet Kapitale		215,000.00	383,418.34	383,418.34	273,101.14	71.23%	71.23%
Granti i Përgjithshëm	1	1,499,553.00	1,501,565.56	1,430,394.89	1,416,781.67	94.35%	99.05%
Paga dhe Meditje		1,154,611.00	1,156,623.56	1,085,452.89	1,081,429.77	93.50%	99.63%
Mallrat dhe Shërbimet		196,580.00	196,580.00	196,580.00	191,136.55	97.23%	97.23%
Shpenzimet Komunale		36,200.00	36,200.00	36,200.00	32,053.35	88.55%	88.55%
Subvencione dhe Transferet		20,000.00	20,000.00	20,000.00	20,000.00	100.00%	100.00%
Investimet Kapitale		92,162.00	92,162.00	92,162.00	92,162.00	100.00%	100.00%
Huamarrja	2	-	21,429.72	21,429.72	21,429.72	100.00%	100.00%
Paga dhe Meditje		-	21,429.72	21,429.72	21,429.72	100.00%	100.00%
Mallrat dhe Shërbimet		-	-	-	-	#DIV/0!	#DIV/0!
Shpenzimet Komunale		-	-	-	-	#DIV/0!	#DIV/0!
Subvencione dhe Transferet		-	-	-	-	#DIV/0!	#DIV/0!
Investimet Kapitale		-	-	-	-	#DIV/0!	#DIV/0!
Të hyrat vetanake	3	159,038.00	300,757.19	300,757.19	153,224.71	50.95%	50.95%
Paga dhe Meditje		-	-	-	-	#DIV/0!	#DIV/0!
Mallrat dhe Shërbimet		6,200.00	57,919.19	57,919.19	18,309.56	31.61%	31.61%
Shpenzimet Komunale		-	-	-	-	#DIV/0!	#DIV/0!
Subvencione dhe Transferet		30,000.00	30,000.00	30,000.00	29,935.82	99.79%	99.79%
Investimet Kapitale		122,838.00	212,838.00	212,838.00	104,979.33	49.32%	49.32%
Mjetet e bartura	4	-	91,915.99	91,915.99	91,909.81	99.99%	99.99%
Paga dhe Meditje		-	-	-	-	#DIV/0!	#DIV/0!
Mallrat dhe Shërbimet		-	7,000.00	7,000.00	7,000.00	100.00%	100.00%
Shpenzimet Komunale		-	-	-	-	#DIV/0!	#DIV/0!
Subvencione dhe Transferet		-	8,950.00	8,950.00	8,950.00	100.00%	100.00%
Investimet Kapitale		-	75,965.99	75,965.99	75,959.81	99.99%	99.99%
Grantet - Donacionet	5	-	2,469.85	2,469.85	-	0.00%	0.00%
Paga dhe Meditje		-	-	-	-	#DIV/0!	#DIV/0!
Mallrat dhe Shërbimet		-	17.50	17.50	-	0.00%	0.00%
Shpenzimet Komunale		-	-	-	-	#DIV/0!	#DIV/0!
Subvencione dhe Transferet		-	-	-	-	#DIV/0!	#DIV/0!
Investimet Kapitale		-	2,452.35	2,452.35	-	0.00%	0.00%

Gjatë vitit 2022 ka ndryshime në mes të buxhetit fillestar dhe aktual siç janë:

Transferi i donacioneve në shumë totale **2,469.85 €**, prej tyre **260.98 €** nga **UN-HABITAT** janë bartur në kategorinë e investimeve kapitale, **17.50 €** nga **KOSTT** në kategorinë Mallra dhe shërbime, **356.50€** nga **SAVE THE CHILDREN** janë bartur në kategorinë e investimeve kapitale, **1,834.87€** nga **DEMOS** dhe **SIDA** janë bartur në kategorinë e investimeve kapitale .

Kategoria e pagave është rritur në shumë prej **23,442.28€** për mbulimin e shtesave në paga për përfituesit nga Ligji për rimëkëmbje ekonomike për punëtorët shëndetësor në QKMF.

Transferi i të hyrave të pashpenzuara të vitit 2021 të bartura për shpenzim në vitin 2022 në shumë prej **91,915.99 €**, prej tyre: 7,000.00€ në kategorinë e Mallrave dhe Shërbimeve, 8,950.00€ në kategorinë e Subvencioneve dhe transfereve dhe 75,965.99€ në kategorinë e investimeve kapitale.

Rritja e të hyrave vetanake të vitit 2022 në shumë prej **141,719.19€**, prej tyre 90,000.00€ në kategorinë e investimeve kapitale, 51,719.19€ në kategorinë e Mallrave dhe Shërbimeve


TË HYRAT BUXHETORE 2022

Pasqyra aktuale Buxhetore 2022, si dhe pasqyrat finale buxhetore për vitet paraprake

Tabela - 2

Burimi i mjeteve	Pranimet 2019	Pranimet 2020	Pranimet 2021	Pranimet 2022	Progresi 22/21	Progresi 22/20
1	2	3	4	5	7=5/4	8=5/3
Grandi Qeveritar	1,656,605.99	1,773,126.24	1,390,864.63	1,522,995.28	109.50%	85.89%
Të hyrat vetanake	138,343.75	137,199.00	122,802.00	300,757.19	244.91%	219.21%
Mjetet e Bartura	87,611.88	95,039.25	31,830.15	91,915.99	288.77%	96.71%
Donacionet	75,373.75	2,469.85	2,469.85	2,469.85	100.00%	100.00%
Gjithsej	1,957,935.37	2,007,834.34	1,547,966.63	1,918,138.31	123.91%	95.53%

GRAFIKONI I BURIMEVE FINANCIARE KOMUNALE (% E PJESMARRJES)




TË HYRAT PERIODIKE NGA GRANTI I QEVERISË

	2022	2021	2020	2019
	BKK	BKK	BKK	BKK
Klasifikimi ekonomik	€ '	€ '	€ '	€ '
Pagat dhe rrogat	1,178,053.28	1,114,761.63	1,169,345.40	1,127,722.99
Mallrat dhe shërbimet	196,580.00	166,900.00	210,526.80	172,899.00
Shërbimet komunale	36,200.00	36,200.00	34,851.13	36,200.00
Subvencionet dhe transferet	20,000.00	-	10,000.00	-
Shpenzimet kapitale	92,162.00	73,003.00	352,279.59	334,386.00
Rezerva				-
	1,522,995.28	1,390,864.63	1,777,002.92	1,671,207.99

TË HYRAT VETANAKE PERIODIKE 2022


Përveç Grandeve të marra nga niveli qendror, për qëllimet e shpenzimeve të përgjithshme, Komuna ka grumbulluar edhe të hyra vetanake. Ekzistojnë disa kategori kryesore të hyrave vetanake komunale: Tatimi në pronë, Te hyrat nga Shëndetësia, Te hyrat nga Regjistrimi i Automjeteve etj.... Të hyrat totale vetanake të grumbulluara Janar - Dhjetor 2022 kanë arritur në shumën prej **348,369.13 €** duke i përfshirë edhe gjobot e trafikut, që përbën **219.05%** të planifikimit vjetor (**159,038,00€**).

GRAFIKONI I TË HYRAVE VETANAKE PËRIDIKE 2019 - 2022



Të hyrat vetanake kryesore periodike Janar – Dhjetor 2022

Te Hyrat nga:	Realizimi 2019	Realizimi 2020	Realizimi 2021	Planifikimi 2022	Realizimi 2022	Progresi me plan.	Progresi me /2021	Progresi me /2020	% në total
	1	2	3	4	5	6 = 5 / 4	7 = 5 / 3	8 = 5 / 2	9 = 5/total
Tatimi në pronë	72,283.09	61,375.47	89,598.59	92,557.00	96,238.45	104%	107%	157%	28.3%
Te hyrat nga Shendetsia	6,999.90	3,295.50	7,387.00	6,200.00	6,210.50	100%	84%	188%	1.8%
Te hyrat nga Administrata	7,630.00	6,834.00	6,288.00	7,100.00	6,654.50	94%	106%	97%	2.0%
Regjistrimi i Automjeteve	5,918.00	5,814.00	7,194.00	6,000.00	7,668.00	128%	107%	132%	2.3%
Te hyrat nga Gjobat ne trafik	7,085.00	-	-	-	-	#DIV/0!	#DIV/0!	#DIV/0!	0.0%
Te hyrat nga lejet per ushtrim te veprimtarise	15,319.36	4,146.00	4,772.00	10,000.00	12,330.57	123%	258%	297%	3.6%
Te hyrat nga Urbanizmi	52,423.99	14,346.00	19,236.40	30,581.00	14,484.86	47%	75%	101%	4.3%
Të hyrat tjera	19,241.50	3,140.00	5,145.00	6,600.00	196,704.75	2980%	3823%	6264%	57.8%
Totali	186,900.84	98,950.97	139,620.99	159,038.00	340,291.63	214%	244%	344%	100%



Ne kategorinë Të hyrat tjera bëjnë pjesë: (Të hyrat nga Qiraja 2,622.50€, Të hyrat nga shërbimet publike-inspeksioni 2,180.00 €, te hyrat nga konfiskimi i sigurimit 3,700.00€ dhe te hyrat nga ndërrim destinimi i tokës 188,202.25€) gjithsejtë **196,704.75€**

Ne këtë raport nuk janë të përfshira te hyrat nga gjobat e trafikut për periudhën Janar – Dhjetor 2022 në shumë prej 8,077.50 € pasi qe këto te hyra planifikohen dhe transferohen nga niveli qendror.

Periudha Janar - Dhjetor 2022 karakterizohet me një realizim të të hyrave në total 340,291.63 € apo 213.97% në raport me planifikimin vjetor, ndërsa krahasuar me vitin paraprak 2021 kemi realizuar 243.73% apo 143.73% më shumë, shprehur në vlerë monetare diferenca është 200,670.64 € më shumë.


SHPENZIMET BUXHETORE 2022

Planifikimi Buxhetor për 2022 duke përfshirë edhe donacionet dhe mjetet e bartura është **1,918,138.31€**, gjatë kësaj periudhe janë alokuar mjete në vlerë **1,846,967.64€** ndërsa janë shpenzuar **1,683,345.91 €**, apo **91.14%** e buxhetit të alokuar.

Struktura e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike.

Nr	Përshkrimi	2019	2020	2021	2022	alokimet /22	Progresi %	
1	2	3	4	5	6	7	8=6/5	9=6/7
1	Pagat	1,110,999.16	1,169,345.40	1,114,761.63	1,102,859.49	1,106,882.61	98.93%	99.64%
2	Mallra e shërbime	170,607.95	207,054.62	172,167.40	216,446.11	261,516.69	125.72%	82.77%
3	Shpenzi. komunale	29,910.20	32,625.75	29,878.29	32,053.35	36,200.00	107.28%	88.55%
4	Subvencione	30,500.00	40,500.00	21,550.00	58,885.82	58,950.00	273.25%	99.89%
5	Shpenzi. Kapitale	541,755.52	474,584.66	121,334.45	273,101.14	383,418.34	225.08%	71.23%
Totali		1,883,772.83	1,924,110.43	1,459,691.77	1,683,345.91	1,846,967.64	115.32%	91.14%

GRAFIKONI I SHPENZIMEVE DHE % E PJESMARRJES NË SHPENZIMET



- Pagat dhe mëditjet të alokuara në vlerë 1,106,882.61€ janë shpenzuar 1,102,859.49€ apo 99,64% e mjeteve të alokuara. Mjetet e pashpenzuara në këtë kategori janë në vlerë prej 75,193.79€, ose në përqindje 6.38% janë mbetje nga granti i përgjithshëm. Krahasuar me vitin paraprak shpenzimi në këtë kategori është më i ultë për 1.07% për shkak të ndikimit të ndryshimeve bazuar në ligjin për rimëkëmbje ekonomike dhe të përvojës së punës si dhe rekrutimit të stafit të ri pas ndryshimeve gjatë vitit. Pjesëmarrja e pagave në shpenzimin e përgjithshëm Komunal është 65.52%.
- Mallrat & shërbimet të alokuara në vlerë 261,516.69€ janë shpenzuar 216,446.11€ në përqindje 82.77% e mjeteve të alokuara. Mjetet e pashpenzuara në këtë kategori janë në vlerë prej 45,070.58€, ose në përqindje 17.23%, nga të cilat 17.50 € janë mbetje nga Donacionet, 39,609.63€ janë mbetje nga të hyrat vetanake dhe 5,443.45€ nga granti i përgjithshëm të cilat kanë mbetur nga pagesat e ndryshme të bëra në kode dhe programe të ndryshme. Krahasuar me vitin paraprak kemi shpenzime më të larta për 25.72% për shkak shlyerjes së obligimeve të mbetura nga viti paraprak. Pjesëmarrja e Mallrave & Shërbimeve në shpenzimin e përgjithshëm Komunal është 12.86%.
- Shpenzimet komunale - Komunalit të alokuara në vlerë 36,200.00€ janë shpenzuar 32,053.35€ ose në shkallën prej 88.55% të mjeteve të alokuara. Mjetet e pashpenzuara në këtë kategori janë në vlerë prej 4,146.65€ ose në përqindje 11.45% janë mbetje nga granti i përgjithshëm të cilat kanë mbetur nga pagesat e ndryshme të bëra në kode dhe programe të ndryshme. Krahasuar me vitin paraprak kemi shpenzime më të larta për 7.28%. Pjesëmarrja e shpenzimeve komunale në shpenzimin total komunal është 1.90%.
- Subvencionet të alokuara në vlerë 58,950.00€ janë shpenzuar 58,885.82€ ose në shkallën prej 99.89% të mjeteve të alokuara. Mjetet e pashpenzuara në këtë kategori janë në vlerë prej 64.18€ ose në përqindje 0.11% janë mbetje nga të hyrat vetanake të cilat kanë mbetur nga pagesat e ndryshme të bëra në kode dhe programe të ndryshme. Krahasuar me vitin paraprak kemi shpenzime më të larta për 173.25% për shkak shlyerjes së obligimeve të mbetura nga viti paraprak. Pjesëmarrja e shpenzimeve të subvencioneve në shpenzimin total komunal është 3.50%.
- Shpenzimet kapitale të alokuara në vlerë prej 383,418.34€ janë shpenzuar 273,101.14€ ose në shkallën prej 71.23% të mjeteve të alokuara. Mjetet e pashpenzuara në këtë kategori janë në vlerë prej 110,317.20€ ose në përqindje 28.77% nga të cilat 107,858.67 € janë mbetje nga të hyrat vetanake, 2,452.35€ janë mbetje nga Donacionet dhe 6.18€ nga të hyrat e bartura nga viti 2021 të cilat kanë mbetur nga pagesat e ndryshme të bëra në kode dhe programe të ndryshme. Krahasuar me vitin paraprak kemi shpenzime më të larta për 125.08%. Pjesëmarrja e shpenzimeve kapitale në shpenzimin total komunal është 16.22%.
- Në total mjetet e alokuara për vitin 2022 në vlerë prej 1,846,967.64€ janë shpenzuar në vlerë prej 1,683,345.91€ ose në shkallën 91.14% të mjeteve të alokuara, krahasuar me vitin 2021 shpenzimet janë më të larta për 15.32%.

RAPORTI DETAL I SHPENZIMEVE NË PAGA , MALLA & SHERBIME SIPAS DREJTORIVE

Përshkrimi	Z.Kryetarit	Administrata	Zh. Ekono.	Sh. Publike	K. Komunal	B.Financa	Urbanizem
Paga neto	63,320.41	72,913.86	41,486.56	38,220.97	47,523.58	50,275.78	36,724.86
Sindikata -0.1% te 0.50%	-	90.55	49.48	54.98	-	19.89	58.29
Antarsimi Oda e Infermiereve	-	-	-	-	-	-	-
Antarsimi Oda e Mjekve	-	-	-	-	-	-	-
Tatimi në paga	4,728.81	3,301.89	2,169.79	2,313.89	1,568.65	2,406.75	2,265.61
Kontributi pensional i punëtorëve	3,581.62	4,016.17	2,300.42	2,101.96	2,583.85	2,732.66	1,634.56
Kontributi pensional i Punëdhënësit	3,581.62	4,016.17	2,300.42	2,101.96	2,583.85	2,732.66	1,634.56
Vendim gjykate	-	-	-	-	-	-	-
TOTALI I PAGAVE & MED.	75,212.46	84,338.64	48,306.67	44,793.76	54,259.93	58,167.74	42,317.88
Shpenzimet e udhtimit në Vendë	-	28.00	-	-	-	-	-
Shpenzimet e udhet. Jashtë Vendlit	120.00	-	-	234.40	-	-	-
Shpenzimet e internetit	-	-	-	-	-	50.00	-
Shpenzimet tjera te telefonit	1,939.62	2,279.51	417.39	631.34	198.64	782.98	554.83
Shpenz. e Tjera te kom. (postare)	-	350.70	-	-	-	768.58	-
Sherbimet e perfaqesimit avokatur	-	1,398.00	-	-	-	699.00	699.00
Shërbime shtypje jo marketing	-	-	-	-	-	-	-
Shërbime kontraktuese tjera	668.39	31,084.81	5,035.76	23,634.92	-	2,053.03	173.91
Shërbime teknike	-	99.45	-	-	-	-	-
Shpenzimet per anëtaresim	-	-	-	912.60	-	-	-
Mobile me pak se 1000€	-	-	-	-	-	-	-
Kompjuterë me pak se 1000€	-	-	-	-	-	-	-
Makina fotokopjuese	-	-	-	-	-	-	-
Pajisje tjera	-	1,526.58	-	879.00	-	-	-
Pajisje trafiku < 1000	-	-	-	1,300.00	-	-	-
Mobile (1000 - 5000)	-	-	-	-	-	-	-
Telefona	-	-	-	-	-	-	-
Furnizim i Zyrës	-	458.00	994.90	-	-	-	-
Furnizim me ushqim dhe pije	188.75	-	-	153.65	70.00	73.80	-
Furnizim me medikamente	-	-	-	-	-	-	-
Furnizim higjienike	-	896.65	-	-	-	-	-
Shpenzimet e veshmbathjes	-	-	-	-	-	-	-
Akomodimi	-	-	-	-	-	-	-
Shpenzimet e varrimit	-	-	-	-	-	-	-
Vaj	-	-	-	-	-	-	-
Nafta për ngrohje	-	4,659.62	-	540.70	2,952.98	-	-
Dru	-	-	-	-	-	-	-
Karburant për Gjenerator	-	540.70	-	-	-	777.10	-
Karburant për automjete	2,162.44	1,718.41	1,449.67	6,413.21	-	522.28	716.41
Avans për para te imet (patty cash)	-	-	-	-	-	-	-
Previzion Bankar	-	-	-	-	-	-	-
Regjistrimi dhe sig.automjeteve	-	1,114.99	-	1,556.90	-	-	-
Taksa komunale e rexe.automjetit	-	-	-	-	-	-	-
Sigur.I ndërtesave dhe të tjerave	-	-	-	-	-	-	-
Mirëm. dhe riparim i automjeteve	-	953.80	-	981.76	-	-	-
Mirëmbajtja e ndërtesave	-	1,116.30	-	-	-	-	-
Mirëmbajtja e rrugëve	-	-	697.80	-	-	-	2,654.00
Mirëmb.e teknologjisë informatike	-	-	-	-	-	-	-
Mirëmbajtja e mobileve&pajisjeve	-	80.00	-	485.50	-	-	-
Qiraja	-	-	-	-	-	-	3,740.00
Reklammat dhe konkurset	480.00	480.00	-	-	-	480.00	-
Botime dhe publikime	-	-	-	-	-	-	-
Dreka zyrtare	1,090.60	136.12	980.00	400.60	148.00	369.00	560.80
Vendim gjykate	-	-	-	-	-	-	-
Pag.neni 39.2 LMFPF	-	-	-	-	-	-	-
TOTALI M & SH	6,649.80	48,921.64	9,575.52	38,124.58	3,369.62	6,575.77	9,098.95

RAPORTI DETAL I SHPENZIMEVE NË PAGA , MALLA & SHERBIME SIPAS DREJTORIVE

Përshkrimi	Ad. Arsim	Ars. fillor	A. i mesem	Ad. Shendet.	QKMF	Sh. Sociale	ZLK	Totali periodik 2022
Paga neto	29,334.96	234,553.25	100,597.21	13,179.88	197,918.22	9,048.55	5,844.32	940,942.41
Sindikata -0.1% te 0.50%	37.14	809.70	362.88	-	758.35	30.26	-	2,271.52
Antarsimi Oda e Infermiereve	-	-	-	-	434.24	-	-	434.24
Antarsimi Oda e Mjekve					400.00			400.00
Tatimi në paga	1,798.85	13,137.77	5,785.80	872.59	13,802.66	445.08	354.94	54,953.08
Kontributi pensional i punëtorëve	1,640.62	13,018.49	5,618.38	739.61	11,133.18	501.30	326.30	51,929.12
Kontributi pensional i Punëdhënësit	1,640.62	13,018.49	5,618.38	739.61	11,133.18	501.30	326.30	51,929.12
Vendim gjykate								-
TOTALI I PAGAVE & MED.	34,452.19	274,537.70	117,982.65	15,531.69	235,579.83	10,526.49	6,851.86	1,102,859.49
Shpenzimet e udhtimit në Vendë	-	11.80						39.80
Shpenzimet e udhet. Jashtë Vendi								354.40
Shpenzimet e internetit								50.00
Shpenzimet tjera te telefonit	818.27		70.00	280.16		82.58	-	8,055.32
Shpenz. e Tjera te kom. (postare)								1,119.28
Sherbimet e perfaqesimit avokatur								2,796.00
Shërbime shtypje jo marketing								-
Shërbime kontraktuese tjera	1,476.75	27,319.12	2,907.48	72.00	7,230.00	171.50	-	101,827.67
Shërbime teknike		159.07			140.00	140.00		538.52
Shpenzimet per anëtaresim								912.60
Mobile me pak se 1000€								-
Kompjuterë me pak se 1000€								-
Makina fotokopjuese								-
Pajisje tjera		79.13		104.20				2,588.91
Pajisje trafiku < 1000								1,300.00
Mobile (1000 - 5000)								-
Telefona								-
Furnizim i Zyrës		399.90			875.22			2,728.02
Furnizim me ushqim dhe pije	64.42	18.00	54.00	45.80				668.42
Furnizim me medikamente					7,887.80			7,887.80
Furnizim higjienike					477.60	649.55		2,023.80
Shpenzimet e veshmbathjes								-
Akomodimi								-
Shpenzimet e varrimit								-
Vaj								-
Nafta për ngrohje				2,229.40	6,771.19			17,153.89
Dru	570.00	7,008.00	6,862.00					14,440.00
Karburant për Gjenerator					1,241.99	777.10		3,336.89
Karburant për automjete	408.35			1,097.43		1,586.42	-	16,074.62
Avans për para te imet (patty cash)		-		-				-
Previzion Bankar								-
Regjistrimi dhe sig.automjeteve								2,671.89
Taksa komunale e rehx.automjetit								-
Sigur.I ndërtesave dhe të tjerave								-
Mirëm. dhe riparim i automjeteve	-	-	-				-	1,935.56
Mirëmbajtja e ndërtesave		6,351.00		210.00	4,166.50			11,843.80
Mirëmbajtja e rrugëve								3,351.80
Mirëmb. e teknologjisë informatike								-
Mirëmbajtja e mobileve&pajisjeve	225.00		651.70	150.00	1,969.00			3,561.20
Qiraja								3,740.00
Reklamat dhe konkurset								1,440.00
Botime dhe publikime								-
Dreka zyrtare	154.00	66.80	100.00					4,005.92
Vendim gjykate								-
Pag.neni 39.2 LMFPP								-
TOTALI M & SH	3,716.79	41,412.82	10,645.18	4,188.99	30,759.30	3,407.15	-	216,446.11

SHPENZIMET ANALITIKE KOMUNALIVE, SUBVENCIONEVE DHE INVESTIMEVE KAPITALE

Përshkrimi	Z.Kryetarit	Administrata	Zh. Ekono.	Sh. Publike	K. Komunal	B.Financa	Urbanizem
Shpenzimet e energjisë elektrike		6,162.15	95.24	12,332.14	-		
Shpenzimet e Ujët		161.04	56.00	452.61	-		
Shpenzimet e Mbeturinave	-			102.39	-	-	-
Shpenzimet e Ngrohjes							
Shpenzimet Telefonike	110.57	118.04		362.78	-	64.47	
Pagesa Vendime gjyqsore		-	-	-	-	-	-
TOTALI KOMUNALËVE	110.57	6,441.23	151.24	13,249.92	-	64.47	-
Subvencionet per etnitetet publike	3,688.69						
Subvencionet per etnitetet jopublike	5,910.26						
Pagesa per perfituesit individual	49,286.87						
TOTALI SUBVENCIONEVE	58,885.82	-	-	-	-	-	-
Ndërtesa te banuara							
Objekte Arsimore							
Objektet kuturore			12,248.10				
Objektet shendetesore							
Auto Rugëve							
Rrugët Lokale			26,793.75	112,514.82			26,041.99
Trotualet							
Kanalizimi			21,930.85				
Ujësjiellësi							
Furniz.Rrymë							
Paisje speciale mjeksore							
Pajisje tjera							
Mirmbajtja investive			10,440.05				
automjete transporti (autoambulanca)							
Transaksione Kapitale - enti. Publ.							
Pag.neni 39.2 LMFPP							
Vendim gjykate			11,480.21				51,651.37
TOTALI I INVESTIMEVE	-	-	82,892.96	112,514.82	-	-	77,693.36
TOTALI I PËRGJITHSHËM	140,858.65	139,701.51	140,926.39	208,683.08	57,629.55	64,807.98	129,110.19

Përshkrimi	Ad. Arsim	Ars. fillor	A. i mesem	Ad. Shendet.	QKMF	Sh. Sociale	ZLK	Totali periodik 2022
Shpenzimet e energjisë elektrike		1,948.44	1,275.67		5,055.00	824.15		27,692.79
Shpenzimet e Ujët		1,325.53	332.25	-	187.23	34.30	-	2,548.96
Shpenzimet e Mbeturinave		204.80		-	102.39		-	409.58
Shpenzimet e Ngrohjes								-
Shpenzimet Telefonike		59.88	183.47	-	298.87	203.94	-	1,402.02
Pagesa Vendime gjyqsore								-
TOTALI KOMUNALËVE	-	3,538.65	1,791.39	-	5,643.49	1,062.39	-	32,053.35
Subvencionet per etnitetet publike								3,688.69
Subvencionet per etnitetet jopublike								5,910.26
Pagesa per perfituesit individual								49,286.87
TOTALI SUBVENCIONEVE	-	-	-	-	-	-	-	58,885.82
Ndërtesa te banuara								-
Objekte Arsimore								-
Objektet kuturore								12,248.10
Objektet shendetesore								-
Auto Rugëve								-
Rrugët Lokale								165,350.56
Trotualet								-
Kanalizimi								21,930.85
Ujësjiellësi								-
Furniz.Rrymë								-
Paisje speciale mjeksore								-
Pajisje tjera								-
Mirmbajtja investive								10,440.05
automjete transporti (autoambulanca)								-
Transaksione Kapitale - enti. Publ.								-
Pag.neni 39.2 LMFPP								-
Vendim gjykate								63,131.58
TOTALI I INVESTIMEVE	-	-	-	-	-	-	-	273,101.14
TOTALI I PËRGJITHSHËM	38,168.98	319,489.17	130,419.22	19,720.68	271,982.62	14,996.03	6,851.86	1,683,345.91

Shënime shpjeguese:

Në totalin e pagave të shpenzuara në vlerë prej **1,102,859.49€** janë nga granti i përgjithshëm **1,081,429.77€** dhe nga fondi i huamarrjes **21,429.72€**, për pagesën e pagave dhe shtesave të punëtorëve në listën e pagave.

Kategoria e Mallrave dhe shërbimeve të shpenzuara në vlerë prej **216,446.11€** nga granti i përgjithshëm janë **191,136.55€**, nga të hyrat vetanake te vitit 2022 janë **18,309.56€** dhe **7,000.00€** janë nga te hyrat e bartura te vitit 2021.

Kategoria e Komunalive të shpenzuara në vlerë prej **32,053.35€** të gjitha janë nga granti i përgjithshëm.

Kategoria e Subvencioneve të shpenzuara në vlerë prej **58,885.82€** nga granti i përgjithshëm janë **20,000.00€**, nga te hyrat vetanake te vitit 2022 janë **29,935.82€** dhe **8,950.00€** janë nga te hyrat e bartura te vitit 2021.


Kategoria e Investimeve Kapitale të shpenzuara në vlerë prej **273,101.14€** nga granti i përgjithshëm janë **92,162.00€** nga te hyrat vetanake te vitit 2022 janë **104,979.33€** dhe **75,959.81€** janë nga te hyrat e bartura te vitit 2021.

.

Shpenzimet sipas Drejtorive dhe progresi me periudhën e njëjtë të viteve paraprake

Shpenzimet Periodike sipas Drejtorive 2019-2022								
	Drejtoritë	2019	2020	2021	2022	Alokimet 2022	Progr. / alokim	Progr. / me 2021
1	Zyra e Kryetarit	127,922.65	125,143.23	102,970.48	140,858.65	140,962.46	99.9%	136.8%
2	Kuvendi Komunal	58,683.22	56,448.86	55,772.14	57,629.55	58,259.93	98.9%	103.3%
3	Administratë	251,640.65	216,186.17	125,643.42	139,701.51	140,358.64	99.5%	111.2%
4	Buxhet dhe Financa	68,912.27	63,703.98	64,453.08	64,807.98	65,267.74	99.3%	100.6%
5	Zhvillimi Ekonomik	358,291.19	442,799.53	75,493.99	140,926.39	226,895.11	62.1%	186.7%
6	Sh.publike	195,564.03	129,996.38	158,306.17	208,683.08	231,497.16	90.1%	131.8%
7	Planifikimi urban	64,619.62	64,629.73	108,711.39	129,110.19	161,954.57	79.7%	118.8%
8	ZKK	6,483.24	3,792.05	2,873.15	6,851.86	6,851.86	100.0%	238.5%
9	Shëndetsia	272,507.82	345,407.40	287,173.45	306,699.33	311,561.13	98.4%	106.8%
12	Arsimi	479,148.14	476,003.10	478,294.50	488,077.37	503,359.04	97.0%	102.0%
Totali Buxhetor		1,883,772.83	1,924,110.43	1,459,691.77	1,683,345.91	1,846,967.64	91.1%	115.3%

GRAFIKONI I SHPENZIMEVE TE DREJTORIVE SI DHE PJESMARRJA NE SHPENZIMIN TOTAL



Në kuadër të Shëndetësisë janë të përfshira: Drejtoria e Shëndetësisë (Administrata), QKMF dhe Shërbimet Sociale.

Në kuadër të Arsimit janë të përfshira: Drejtoria e Arsimit (Administrata), Arsimi fillor dhe Arsimi i mesëm.

❖ Progresi i shpenzimeve kapitale sipas projekteve për vitin 2022

Emri i projektit	Kodi i projektit në Thesar	Buxheti 2022	Alokimet / 2022	Shpenzimet aktuale I - XII / 2022	Struktura në %
	1	2	3	4	5
Asfaltimi i rrugës lokale Junik - Jasiq	51315	111,953.40	111,953.40	97,523.82	87.11
Rehabilitim i rrugëve lokale	46031	15,000.00	15,000.00	14,991.00	99.94
Bashkëfinancim i projekteve	46030	139,012.59	139,012.59	56,108.36	40.36
Ndërtimi i kanaleve të ujitjes	47283	22,000.00	22,000.00	21,930.85	99.69
Rregullimi i hapsirave sportive, rekreative dhe të amb	51003	10,000.00	10,000.00	-	-
Asfaltimi i rrugëve Lokale	45605	28,000.00	28,000.00	27,693.36	98.90
Hapja e rrugëve fushore	88352	5,000.00	5,000.00	4,793.75	95.88
Ndërtimi i sheshit të qendres së komunes së Junikut	51595	50,000.00	50,000.00	50,000.00	100.00
Participim i projekteve - (Un-Habitat)	88351	260.98	260.98	-	-
Permiros. i qasjes (Save the children)	94618	356.50	356.50	-	-
Ngritja e Performances (DEMOS)	92052	1,834.87	1,834.87	-	-
Totali		383,418.34	383,418.34	273,041.14	71.21

*Ne projektin Ndërtimi i sheshit të qendrës së komunës së Junikut” është bërë pagesa sipas Urdhrit përmbartimor në emër të projektit “Ndërtimi i ujësjellësit në lagjen Agim Ramadani” Projekt i vitit të kaluar të mbetur si obligime të cilat janë ekzekutuar në vitin 2022 në shumë totale prej 52,651.37€ prej tyre: 50,000.00 janë nga projekti Ndërtimi i sheshit të qendrës së Komunës së Junikut, 1,651.37 nga projekti Asfaltimi i rrugëve Lokale dhe 1,000.00 nga projekti Hapja e Rrugëve Fushore.

Në Projektin bashkëfinancim i projekteve në vlerë prej 56,108.36€ janë të përfshira: Ndërtimi i stacionit të autobusëve në vlerë prej 10,440.05€ në bashkëfinancim me Ministrinë e Zhvillimit Rajonal, Asfaltimi i rrugës Junik Jasiq Gjocaj në vlerë prej 23,000.00, në bashkëfinancim me Ministrinë e Mjedisit dhe planifikimit hapësinor, Ndërtimi i qendrës për kulturë turizëm dhe Agrobiznes në vlerë prej 12,248.10€ në bashkëfinancim me Ministrinë e Administrimit të pushtetit Lokal. Shpenzimet sipas urdhrit përmbartimor në shumë prej 10,480.21€ prej tyre 3,705.27€ për projektin Ndërtimi i parkut të lojërave për fëmijë dhe 6,774.94€ për KRU Drini i Bardhë.

Mjetet e alokuara për Investime kapitale janë 383,418.34€ nga këto burime:

- Grandi 92,162.00€ + Te hyrat vetanake 212,838.000€ + Te hyrat e bartura 75,965.99€ dhe 2,452.35€ nga donacionet.

Realizimi i buxhetit për investime kapitale në total është 273,041.14€ , prej tyre (92,162.00€ nga Grandi + 104,979.33€ nga të hyrat vetanake + 75,959.81€ nga të hyrat e bartura dhe 0.00€ nga Donacionet).

Progresi i realizimit të investimeve Kapitale karshi mjeteve të alokuara për vitin 2022 është **71.23%** .

PASQYRA E OBLIGIMEVE TË PA PAGUARA JANAR– DHJETOR 2022

Programet Buxhetore	M&SH	Komunali	Subvencione	Kapitale	Gjithsej	Borgji momental	Pagesa deri me 00/00/22
	394.95	-	-	-	394.95		
					-		-
					-		-
					-		-
					-		-
GJITHSEJ	395.0	-	-	-	394.95	-	-

Të arkëtueshmet

		2022
Kodi ekonomik	Përshkrimi	€ '000
40110	Tatim ne prone	190,944.44
50019	Licenca (Ushtrimi i veprimtarisë)	62,908.43
Gjithsej		253,852.87

❖ REKAPITULLIMI I INFORMATËS FINANCIARE

Kjo informatë periodike Janar – Dhjetor / 2022 ka për qëllim informimin detal dhe objektiv për të gjithë treguesit financiar, qofshin pozitive apo negative.

Qëllimi kryesor i këtij raporti është që rezultatet pozitive të menaxhimit të këtij buxheti ti forcojmë dhe ti rrisim më tutje, ndërsa treguesit negativë ti eliminojmë gjatë periudhave në vijim. E tërë kjo me qëllim që të jemi sa më të suksesshëm në realizimin e të hyrave dhe shpenzimeve për qëllimet e përcaktuara me planet dinamike të veprimit sipas ligjit mbi Buxhetin.

❖ PLANIFIKIMI BUXHETOR JANAR - DHJETOR 2022

Buxheti fillestar i aprovuar nga Kuvendi Komunal në vlerë **1,658,591.00 €** ka pasur ndryshime – rritje në periudhën Janar – Dhjetor 2022 për: **2,469.85 €** nga mjetet e pranuar nga donacionet dhe donacionet e bartura nga viti 2021, **91,915.99€** nga te hyrat e pashpenzuara te vitit 2021 te bartura për shpenzim në vitin 2022 dhe **23,442.28€** nga niveli Qendror për mbulimin e shtesave për përfituesit nga Ligji për rimëkëmbje ekonomike për punëtorët shëndetësor ne QKMF. Me vendim nga kuvendi komunal është bërë rritja e planit te te hyrave vetanake për vitin 2022 në shumë prej **141,719.19 €**. Do të thotë buxheti total për vitin 2022 ka vlerën: **1,918,138.31€**.

❖ SHPENZIMET BUXHETORE PERIODIKE JANAR - DHJETOR 2022

- **Shpenzimet nga Grandi qeveritar:** Komuna ka pranuar mjete në vlerë **1,522,995.28€** ka shpenzuar **1,438,211.39€** që do të thotë **94,43%** të mjeteve të alokuara.
- **Shpenzimet nga të hyrat vetanake:** Mjetet e alokuara nga ky burim janë **300,757.19€**, janë shpenzuar **153,224.71€** që do të thotë **50,95%** te mjeteve të alokuara.
- **Shpenzimet nga Mjetet e bartura të viti paraprak:** Mjetet e alokuara nga ky burim janë **91,915.99€**, janë shpenzuar **91,909.81€** që do të thotë **99.99%** te mjeteve të alokuara.
- **Shpenzimet nga Donacionet dhe Participimet:** Nga mjetet e pranuar në vlerë **2,469.85€** janë shpenzuar **0.00€** ose **0.00%** të mjeteve të alokuara – pranuar.

- Ne përgjithësi në vitin 2022 vlen të përmendet efikasitet i lartë në menaxhimin e buxhetit (pagesa) 91.14% e mjeteve të alokuara buxhetore, krahasuar me vitin 2021 kemi shpenzime më të larta prej 15.3%.

❖ **TË HYRAT BUXHETORE PERIODIKE JANAR - DHJETOR 2022**

- **Të Hyrat Vetanake:** Komuna ka realizuar dhe alokuar të hyra vetanake në periudhën Janar - Dhjetor 2022, me të hyra të bartura dhe donacione **395,143.03€** ose 21.39% të alokimeve prej **1,846,967.64€**.

- **Pengesat që kanë ndikuar në rezultate edhe më të mëdha janë:**

1. Grandi Qeveritar jo i mjaftueshëm për realizimin e aktiviteteve të parapara nga Komuna dhe kufizimet në planifikimin e shpenzimeve operative.
2. Situata e krijuar pas shfaqjes së pandemisë COVID 19
3. Obligimet e mbetura nga periudha paraprake

Duke pasur parasysh indikatorët e lartë cekur Komuna e Junikut, në Periudhën Janar – Dhjetor 2022 ka arritur rezultate të mira të cilat u bënë të ditura më lartë.

ZKF
Arten Hamza

Drejtori Buxhet e Financa
Vjollca Qestaj

Kryetari i Komunës
Ruzhdi Shehu



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK– MUNICIPALITY OF JUNIK

Bazuar në nenin 12.2 shkronja (c), neni 17, shkronja (h) të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 22, paragrafi 22.1, pika (3) të Statutit të Komunës së Junikut të datës 29.09.2010, nenit 5, shkronja (i) të Ligjit nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, , Ligji Nr. 05/L-087 për Kundërvajtje, (Gazeta Zyrtare E Republikës Së Kosovës / Nr. 33 / 8 Shtator 2016, Prishtinë), Kuvendi komunal në mbledhjen e mbajtur me datë 00.00.0000, miratoi këtë:

**DRAFT RREGULLORE
PËR
INSTITUCIONET EDUKATIVE-ARSIMORE TË KOMUNËS SË JUNIKUT**

**Neni 1
Qëllimi**

Kjo rregullore ka për qëllim të përcaktojë të drejtat dhe obligimet, veprimet e ndaluara, vijueshmërinë në mësim, masat dhe procedurat disiplinore dhe zbatimin e tyre ndaj nxënësve, mësimeve dhe personelit tjetër në shkollë (drejtori, sekretari, pedagogji dhe personeli tekniko-shërbyes).

Neni 2

Rregullorja synon ngritje të cilësisë në procesin edukativo-arsimor, shkallë të lartë demokratizimi brenda sistemit tonë arsimor, atmosferë pozitive në frymën e reformave arsimore, me qëllim që në shkollat tona nxënësi të jetë subjekt qendror, si në mësim, ashtu edhe në aktivitete jashtë mësimore.

Neni 3

Në këtë Rregullore përcaktohen qartë rregullat e organizimit të punës, të drejtat dhe detyrat e organeve vendimmarrëse, të personelit udhëheqës, të mësimeve, të nxënësve, të personelit tekniko-shërbyes në institucionet parashkollë, fillore, të mesme të ulëta dhe të mesme të larta në Komunën e Junikut.

Neni 4

Me këtë rregullore ndalohet çdo formë e diskriminimit, ndasisë apo formë tjetër e shkeljes së të drejtave dhe lirive etnike, fetare dhe gjinore të njeriut. Nxënësit, mësimeve dhe punëtorët e tjerë të shkollës gëzojnë të drejta të barabarta pa marrë parasysh përkatësinë etnike, fetare dhe gjinore .

Neni 5

Kultivimi i tolerancës, i mirësjelljes, i respektit dhe i mirëkuptimit është detyrë e secilit nxënës, mësimitdhënës dhe personelit tjetër në shkollë.

Cenimi i të drejtave elementare të nxënësve, të mësimitdhënësve dhe të personelit tjetër në shkollë në bazë të përkatësisë etnike, fetare ose gjinore konsiderohet si shkelje e rëndë e punës dhe e detyrave të punës.

Neni 6

Zbatimi i kësaj rregulloreje shtrihet në gjithë hapësirën e brendshme dhe të jashtme të institucioneve edukativo-arsimore, gjatë kryerjes së punëve, ose të aktiviteteve që lidhen me procesin edukativ-arsimor, në punën praktike profesionale të shkollave të mesme të larta, në ekskursionet, shëtitje, piknik, kroset, vizita, gara të ndryshme, aksione të punës vullnetare, ose raste të tjera të organizuara nga shkollat.

Neni 7

Nocioni “Institucione edukativo-arsimore” në këtë Rregullore përfshin: institucionet parashkollore (IP), shkollat fillore (SHF), shkollat e mesme të ulëta (SHMU), shkollat e mesme të larta (SHML), përkatësisht nivelet 0, 1, 2, 3 ISCED.

KREU I

ORGANIZIMI I BRENDSHËM I PUNËS NË INSTITUCIONET PARASHKOLLORE, NË SHKOLLAT FILLORE, NË SHKOLLAT E MESME TË ULËTA DHE TË MESME TË LARTA

Neni 8

Struktura organizative e institucioneve edukative-arsimore

1. Struktura organizative e institucioneve edukative-arsimore është:

1.1. Organet qeverisëse dhe vendimmarrëse:

- 1.1.1. Këshilli Drejtues i Shkollës;
- 1.1.2. Drejtori;
- 1.1.3. Sekretari ose administratori.

1.2. Organet profesionale:

- 1.2.1. Këshilli i mësimitdhënësve;
- 1.2.2. Këshilli i klasave;
- 1.2.3. Aktivitetet profesionale.

1.3. Organet përfaqësuese:

- 1.3.1. Këshilli i prindërve;
- 1.3.2. Këshilli i nxënësve.

1.4. Bashkëpunëtorët profesional:

- 1.4.1. Pedagogu;

- 1.4.2. Psikologu;
- 1.4.3. Bibliotekisti;
- 1.4.4. Sociologu.
- 1.5. **Përsonei i mësimdhënësve:**
 - 1.5.1. Mësimdhënësi;
 - 1.5.2. Mësimdhënësi kujdestar i paraleles;
 - 1.5.3. Mësimdhënësi kujdestar i ditës;
 - 1.5.4. Edukator parafillor.
- 1.6. **Personeli Administrativ:**
 - 1.6.1. Sekretari.
- 1.7. **Nxënësit, fëmijët parashkollorë, nxënësit me nevoja të veçanta;**
- 1.8. **Personeli teknik:**
 - 1.8.1. Shtëpiaku/ Mirëmbajtësi i ngrohjes qendrore (fokisti);
 - 1.8.2. Mirëmbajtësit e higjienës;
 - 1.8.3. Rojat e natës.

Neni 9

Puna, obligimet dhe përgjegjësitë e organeve dhe këshillave të institucioneve edukative-arsimore do të detajohen me këtë rregullore.

Neni 10

Orari i punës në Institucionet Edukativo-Arsimore

1. Ora mësimore zgjat 45 minuta.
2. Për institucionet parashkollore orari i punës duhet të bazohet në Udhëzimin Administrativ 19/2016 për përfshirjen e fëmijëve në institucionet parashkollore në Kosovë.
3. Pushimi i shkurtër mes orëve mësimore zgjatë 5 minuta.
4. Pushimi i gjatë zgjat 20 minuta.
5. Ndërrimi i dytë e fillon mësimin 30 minuta pas përfundimit të mësimin të ndërrimit të parë.
6. Drejtori është i obliguar të përpiloj orarin e punës me palë.
7. Shkurtimi i kohëzgjatjes së orës mësimore dhe pushimeve mes orëve të mësimin mund të bëhet në situata specifike vetëm me vendim të DAKRS.

8. Puna dhe detyrat e punës për punonjësit e institucioneve edukativo- arsimore i realizojnë në kuadër të punës javore prej 40 orë të punës dhe atë: për mësimdhënësit 20 orë mësim, 15 orë përgatitje për mësim dhe 5 orë angazhim dhe organizim në aktivitete tjera me nxënësit; për edukator/e 30 orë janë në angazhim të drejtpërdrejt me fëmijët dhe 10 orë përgatitje; ndërsa, personeli administrativ, profesional, ndihmës teknik realizojnë normën e punës prej 40 orë në javë.

ORGANET MENAGJUESE, UDHËHEQËSE DHE PERSONELI TJETËR NË SHKOLLË KËSHILLI DREJTUES I SHKOLLËS

Neni 11

Çdo institucion publik arsimor dhe aftësues, do të formojë Këshillin Drejtues, Këshilli Drejtues i Shkollës është organi më i lartë këshillëdhënës dhe vendimmarrës i shkollës.

Neni 12

Themelimi, përbërja, funksionimi, detyrat dhe përgjegjësitë e Këshillit Drejtues janë të përcaktuara në nenin 17 të Ligjit nr. 04/L-032, për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, dhe në UA 03/2016 të MASHT.

Neni 13 DREJTORI DHE SEKRETARI

Drejtori i përgjigjet vetëm DAKRS. Drejtori i shkollës, çdo vit, i raporton Këshillit Drejtues lidhur me punën, aktivitetet dhe financat e institucionit përkatës që ai udhëheq.

Neni 14 Detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit

1. Drejtori i shkollës, përveç detyrave të përcaktuara me ligj dhe me akte nënligjore, është organi më i lartë drejtues ekzekutiv i shkollës, përgjegjësit e tije janë:

- 1.1 Menaxhimin dhe administrimin e përgjithshëm të institucionit;
- 1.2 Hartimin e planit vjetor të punës dhe planin zhvillimor të institucionit, të cilin e miraton Këshilli Drejtues Shkollës;
- 1.3 Koordinimin e punës dhe bashkëpunimin me aktivet profesionale për ndarjen e normave dhe orëve për mësimdhënëse/edukatorë;
- 1.4 Caktimin e mësimdhënësve kujdestarë të paraleleve dhe kërkon raport prej tyre për punën në paralele;
- 1.5 Caktimin e mësimdhënësve kujdestarë të ditës dhe kërkon raport me shkrim prej tyre;
- 1.6 Caktimin dhe shqiptimin e masave disiplinore ndaj nxënësve;
- 1.7 Caktimin e detyrave për zgjedhjen, vlerësimin, disiplinën dhe çështje të tjera që kanë të bëjnë me punën edukative-arsimore të mësimdhënësve dhe të punëtorëve të tjerë në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- 1.8 Përdorimin efikas të sistemit të informimit për DAKRS-në edhe organet tjera;
- 1.9 Kryerjen me sukses të detyrave dhe obligimeve që dalin nga detyrimi për zbatimin e planeve dhe programeve mësimore aktuale;

- 1.10 Ruajtjen e dokumenteve dhe të dhënave, siç parashihet në aktet normative;
- 1.11 Respektimin e afateve zyrtare;
- 1.12 Respektimin e orarit të punës të përcaktuar nga punëdhënësi;
- 1.13 Monitorimin, hospitimin e orëve mësimore (Formulari për vlerësim) dhe mentorimin (Protokolli për vëzhgim) sipas UA 14/2013;
- 1.14 Vlerësimin e performancës së mësimdhënësve dhe stafit tjetër administrativ-teknik, në mënyrë objektive, për çdo vit shkollor, duke e vendosur një kopje të këtij vlerësimi në dosjen e secilit punëtor, dhe përgatit një raport të përgjithshëm me rekomandime për DAKRS -në;
- 1.15 Mbajtjen e së paku 10 orë mësim në shkollat me më pak se 250 nxënës (Neni 8 pika 1 e UA nr. 18/2009);
- 1.16 Planifikimin e buxhetit të shkollës dhe menaxhimin sipas kërkesave;
- 1.17 Ruajtjen e dokumentacionit financiar dhe dhënien e llogarisë për shpenzimin e buxhetit (mjeteve) të shkollës;
- 1.18 Thirrjen dhe udhëheqjen e mbledhjeve të Këshillit të mësimdhënësve;
- 1.20 Propozimin për dhënien e lëvdatave dhe shpërblimeve për kontributin dhe suksesin e mësimdhënësve në procesin mësimor dhe të nxënësve për rezultatet e arritura në shkollë dhe sukseset e arritura të shkollës;
- 1.21 Për dhënien leje nxënësit deri dy javë mungesë nga shkolla;
- 1.22 Kryerjen e detyrave të tjera të ngarkuara nga DAKRS dhe obligimet e përcaktuara me akte të tjera normative;
- 1.23 Të përgatitë raporte mujore dhe vjetore për DAKRS.

Neni 15

Drejtori, në bashkëpunim me mësimdhënësin kujdestar të paraleles, duhet t'i identifikojnë nxënësit që prishin rendin, disiplinën, që bëjnë dëme materiale të qëllimshme dhe që kanë sjellje asociale. Më pas e njoftojnë prindin e nxënësit dhe, në bashkëpunim me Këshillin Drejtues të Shkollës, marrin masat adekuate që janë paraparë me këtë rregullore. Për çdo vendim që marrin e njoftojnë me shkrim DAKRS -në.

Neni 16

Drejtori është i obliguar që për çdo muaj të përgatisë me shkrim raportin e punës (aktivitetet edukative e arsimore, realizimin e planit mësimor nga mësimdhënësit, vijueshmërinë e personelit dhe të nxënësve, realizimin e planit të punës së shkollës), të monitorojë dhe të monitorojë vazhdimisht dhe të përmbledhë vlerësimin me shkrim të punës së mësimdhënësve dhe të punëtorëve të tjerë në fund të vitit shkollor.

Neni 17

Me rastin e përpilimit të orarit të mësimi nga drejtori, ai nuk mund të planifikojë dy orë për të njëjtën lëndë mësimore brenda ditës (me përjashtim të shkollave profesionale në lëndët profesionale praktike dhe në situata të veçanta).

Neni 18

Drejtori e cakton mësimdhënësin kujdestar të ditës në ditën kur ka më pak orë mësimi.

Neni 19

Drejtori është i obliguar të paraqitet në punë 30 minuta para fillimit të mësimi

Neni 20

Detyrat dhe përgjegjësitë e sekretarit/administratorit

1. Sekretari i shkollës kryen këto detyra:

1.1. Përgatit projektet e akteve normative të shkollës dhe i bën ndryshimet dhe plotësimet e tyre;

1.2. Mban të gjitha shënimet (të dhënat) e mësimdhënësve, të nxënësve dhe të personelit tjetër të shkollës;

1.3. Mban librin amë të të punësuarve dhe kujdeset për evidencën personale (dosjet), për azhurnimin e tyre, për përvojën e punës, për pushimet e lehonisë të mësimdhënësve, kohën e pensionimit, si dhe kryen të gjitha punët e tjera administrative dhe, përmes drejtorit të shkollës, njofton DAKRS -në;

1.4. Ndihmon drejtorin në administrimin, drejtimin e shkollës dhe në të gjitha aktivitetet e shkollës;

1.5. Ndihmon dhe këshillon drejtorin për zbatimin e ligjit, të udhëzimeve administrative të MASHTI dhe të akteve të tjera juridike;

1.6. Ndihmon drejtorin në mbledhjet me prindër, me komunitetin, me arsimtarët dhe me drejtorët e shkollave të tjera lidhur me profilin dhe aktivitetet e shkollës;

1.7. Ndihmon drejtorin në zhvillimin dhe sigurimin e gjithëpërfshirjes, paanësisë dhe në programet e tolerancës;

1.8. Kujdeset për mirëmbajtjen e plotë dhe të saktë të arkivit dhe të administratës së shkollës;

1.9. Regjistron të dhënat në SMIA, harton dhe monitoron statistikat dhe raportet e shkollës;

1.10. Mban procesverbal të shkruar për të gjitha çështjet që lidhen me administratën e shkollës;

1.11. Protokollon çdo kërkesë/ankesë me shkrim që i drejtohet shkollës dhe njofton drejtorin për respektimin e afateve zyrtare për përgjigje;

1.12. Pranon dërgesat postare, letra ose pako etj;

1.13 Përpilon shkresa të ndryshme në emër të shkollës (vendime, urdhëresa, njoftime, vërtetime, përgjigje etj., sipas kërkesës së drejtorit);

1.14 Kontrollon punën e punëtorëve tekniko- shërbyes dhe kërkon llogari për pastërtinë në ambientet brenda dhe jashtë objektit të shkollës /oborr/.

1.15 Kryen edhe detyra të tjera, të caktuara nga drejtori i shkollës, DAKRS -ja apo MASHTI. (ne harmoni me pershkrimin e detyrave te punes)

ORGANET PËRFAQËSUESE NË SHKOLLË

Neni 21

Këshilli i nxënësve

1.Këshilli i nxënësve është organ përfaqësues, të drejtat dhe obligimet e Këshillit të nxënësve janë të përcaktuara me nenin 18 të Ligjit Nr. 04/L- 032 për Arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës.

